


PLANI OPERACIONAL

I ZHVILLIMIT VENDOR

BASHKIA PEQIN



Empowered lives.
Resilient nations.

Mars, 2016

Titulli: Plani Operacional pës Zhvillimin Lokal të Bashkisë Peqin

Autorësia dhe kontributet:

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Peqin dhe Universiteti POLIS me mbështetjen e Projektit STAR (Support to Territorial and Administrative Reform) dhe Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

Grupi i punës: Drejtues (Eranda Janku, Ledio Allkja, Besnik Aliaj, Sotir Dharmo, Elona Karafili, Dea Buza, Elvan Dajko, Endrit Marku); *Të tjerë* (Iva Tavanxhiu, Greta Kukeli, Erni Kocani, Hamez Trezhnjeva, Erisa Poleshi, Jolin Matraku, Jora Vokopola).

Konsulencë: Aurela Bozo (eksperte e jashtme për çështjet gjinore)

Realizimi grafik dhe përmbajtja fotografike : Eranda Janku, Dea Buza

PROFIL, BASHKIA PEQIN

Bashkia e Peqinit pozicionohet në pjesën qendrore të Shqipërisë së Mesme. Kufizohet në veri me Tiranën, në jug me Lushnjën, në perëndim me Kavajën dhe Rogozhinën, në lindje me Elbasanin dhe Belshin. Peqini zë një sipërfaqe prej 150km² dhe ka një popullësi prej 26,136 banorë. Bashkia Peqin përbëhet nga 6 njësi administrative, përkatësisht: njësia Peqin, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë

Bashkia ndodhet midis poleve ekonomike qendrore: Tiranë, Durrës dhe Elbasan, pole të cilat jo vetëm janë të zhvilluara në vetvete dhe funksionojnë tashmë si një sistem (sidomos Zona Ekonomike Tiranë-Durrës), por gjithashtu janë motorri kryesor i sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Duke qenë se Peqini gjendet midis 3 qyteteve më të rëndësishme të Shqipërisë, pikërisht midis Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit itineraret lidhëse midis tyre krijojnë mundësinë që Peqini të kthehet në një pikë të rëndësishme për të zhvillimin ekonomik dhe për t'u lidhur me tregje të ndryshme për të shitur në këtë mënyrë prodhimet e saj dhe të ulë kështu shkallën e varfërisë që njësi të ndryshme shfaqin.

Popullsia në Peqin është 26136 banorë referuar Censurit dhe 37,173 banorë sipas Regjistrimit Civil. Dendësia është rreth 1,690 b/km². Raporti i popullsisë urbane-rurale është 32.1%, që tregon për një dominancë të popullsisë rurale e cila është dhe më e lidhur me tokën dhe punimin e saj. Pjesa urbane gjendet e fokusuar në njësinë Peqin dhe janë të orientuar kryesisht drejt ofrimit të shërbimeve.

Bazuar në të dhënat e INSTAT, sektorët kryesorë ekonomikë në Bashkinë Peqin janë Bujqësia me 70% të të punësuarve, Industria me 7.2 % dhe Shërbimet me 22.8%. Kryesisht të punësuarit në shërbime janë pjesë e administratës publike, ose në sipërmarrje të vogla dhe të mesme brenda qytetit të Peqinit si dhe përgjatë rrugës nacionale Rogozhinë-Pogradec.

Bujqësia në Bashkinë e Peqinit është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë dhe sektori me më shumë të punësuar. Kulturat më të mbjella në këtë zonë janë ulliri me 2991 rrënjë gjithnjë e në rritje, vreshtaria është gjithashtu një kulturë tepër e zhvilluar ku sipërfaqja e mbjellë është rreth 610 ha, ku kultivohen disa varjetete si: moskat, merlot, shesh i zi e i bardhë. Nga kultivimi i kësaj kulture gjithashtu prodhohen edhe nën produktet e saj si vera e rakia. Tokat bujqësore zënë rreth 8,500

ha ku shtrihen përkatësisht në njësitë Gjocaj, Karinë dhe Pajovë. Peqinasit dallohen për prodhimin e vajit të ullirit dhe punishtet e tyre.

Por pavarësisht këtyre potencialeve, Bashkia e Peqinit parashtron një sërë problematikash, të cilat lidhen ngushtësisht me mosmenaxhimin e mirë të territorit dhe mungesën e instrumentave për planifikimin e tij.

Bazuar në profilin, potencialet dhe problematikën e Bashkisë Peqin, është ngritur vizioni i mëposhtëm:

“Bashkia Peqin, do të shfrytëzojë pozicionin e saj strategjik dhe potencialet natyrore, duke synuar promovimin e një identiteti të ri që përfaqëson në rajon një qendër të kulturës së zhvillimit bujqësor. Pjesë e strategjisë së zhvillimit do të jetë përmirësimi i kushteve të jetesës nëpërmjet shfrytëzimit të potencialeve të çdo njësie administrative me anë të nxitjes dhe bashkëpunimit midis tyre. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të kushteve të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve sociale për të siguruar gjithë-përfshirjen e banorëve në të gjithë territorin e bashkisë”.





TABELA E PËRMBAJTJES

6	PËRSE DUHET NJË PLAN OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL
8	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL DHE PROCESET E PLANIFIKIMIT
10	METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL
14	DIAGNOZA PËR BASHKINË PEQIN
28	PROBLEMATIKAT DHE PRIORITETET
33	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL NË BASHKINË PEQIN
46	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIM DHE PLANIFIKIMIN E TERRITORIT
48	ANEKS 1 – PROJEKT FISHAT
92	ANEKS 2 – IMAZHE DHE DIAGRAMA PLOTËSUESE

PËRSE DUHET NJË PLAN OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL?

Në kuadër të reformës administrative territoriale, ndarja administrative e Shqipërisë ka kaluar nga një sistem prej 371 njësi të qeverisjes vendore (65 Bashki + 306 Komuna) në një sistem me 61 Bashki. Në këtë kontekst, Bashkitë e reja tashmë mbulojnë territore shumë herë më të mëdha dhe të shumëllojshme si nga pikëpamja topografike, përdorimi dhe shfrytëzimi i territorit, kompozimi social-ekonomik dhe problematikave të zgjeruara.

Kjo gjë përbën një sfidë jo vetëm për zbatimin e reformës administrative por edhe për vetë kryetarët e Bashkive të cilët duhet të administrojnë e menaxhojnë një territor shumë më të madh, dinamik e kompleks. Një ndër sfidat më të mëdha të Bashkisë është dhe zhvillimi ekonomik lokal. Në këtë kuadër, Bashkitë duhet të shfrytëzojnë më mirë mundësitë për akses në financim për projekte strategjike të cilat shërbejnë si shtytës për zhvillimin ekonomik-social të Bashkisë.

Për këtë arsye, hartimi i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, vjen në ndihmë të Bashkisë duke ofruar projekte konkrete dhe prioritare, të cilat japin zgjidhje disa prej problematikave më eminente të momentit për një periudhë afat-shkurtër prej 1-3 vjetësh. Projekt fishat më pas mund të përdoren e realizohen duke u financuar nga buxheti i Bashkisë, ose duke aplikuar për projekte tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, donatorë të ndryshëm si USAID, UNDP, SIDA, ADA, ADF, IADSA apo edhe tek ministritë respektive, duke lobuar dhe kërkuar implementimin dhe bashkëpunimin e tyre në implementimin e projekteve.

Duke marrë në konsideratë historikun e buxhetit të Bashkisë Peqin dhe situatën aktuale fondet janë të limituara. Kryesisht ato shërbejnë për mbulimin e kostove operationale dhe pagave. Ndërkohë, mungojnë financat për të zhvilluar projekte të cilat kanë kosto të larta dhe impakte të mëdha në territor. Një burim i mirë për financim është aplikimi tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në të cilin janë në dispozicion disa grante si:

- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore;
- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar;
- Granti konkurrues për shëndetësinë;
- Granti konkurrues për objektet kulturore dhe te trashëgimise kulturore;
- Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;
- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh;

- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin;
- Granti konkurrues për pyllëzimin.

Gjithsesi për të aksesuar këto fonde, Bashkitë duhet të konkurojnë me njëra tjetrën dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kenë projekte të elaboruara. Në këtë kontekst, Planit Operacional për Zhvillimin Lokal i vjen në ndihmë Bashkisë Peqin për të aplikuar për financim dhe projekte tek FZHR. Lista e projekteve të elaboruara në Shtojcën e Projekt Fishave, plotëson një gamë të gjerë të problematikave. Si rrjedhojë, këto projekte mund të përdoren për aplikim në më shumë se një grant konkurrues tek FZHR. Gjithashtu, projektet janë formuluar në një mënyrë të tillë që ndërtojnë mbi njëra-tjetrën, kështu rrisin dhe qëndrueshmërinë dhe impaktin e projekteve në territor dhe në zhvillimin e qëndrueshëm vendor.

Bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë Planet e Përgjithshme Vendore brenda një afati kohor prej 2 vjetësh. Në këtë kontekst, Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, shërben si një hap fillestar në proceset e planifikimit por që në asnjë mënyrë nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor. Në të identifikohen problematikat kryesore dhe parashtrihen disa prioritete zhvillimi të cilat më pas duhet të mbështeten me politika të qarta lokale (strategjia e zhvillimit) si dhe të përkthehen në përdorime të përshtatshme të tokës (plani i përdorimit të tokës) të shoqëruara me rregullat përkatëse të zhvillimit (rregullore e planit të përgjithshëm vendor).

PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL DHE PROÇESET E PLANIFIKIMIT



Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Bashkitë, brenda një afati kohor prej dy vjetësh nga miratimi i ligjit duhet të hartojnë planet e përgjithshme vendore. Ky instrument planifikimi, përtej aspektit të lidhur me ndërtimin dhe lejet ndërtimore, do të shërbejë si dokument udhërrëfyes për zhvillimin e qëndrueshëm territorial të Bashkisë.

Në këtë moment, Bashkia Peqin nuk zotëron ndonjë plan të zhvillimit të territorit, dhe njëkohësisht nuk ka filluar proceset e hartimit të planit të përgjithshëm vendor, apo të strategjisë së zhvillimit të territorit. Mungesa e kapaciteteve njerëzore për hartimin e PPV, si dhe mungesa e financave të nevojshme për hartimin e planit me anë të kontraktimit të subjekteve private për këtë gjë është një sfidë shumë e madhe për kryetarin e Bashkisë. Si rrjedhojë, hartimi i një plani operacional për zhvillimin lokal shërben Bashkisë në tre mënyra:

- E para, ndihmon në evidentimin e problematikave kryesore për territorin e ri dhe të zgjeruar të Bashkisë si dhe në ofrimin e zgjidhjeve konkrete me anë të projekteve strategjike të cilat shërbejnë si shtytës për zhvillimin ekonomik.

- E dyta, ndihmon Bashkinë në prioritazimin e projekteve dhe në hartimin e planit buxhetor për 1-3 vitet e ardhshme. Gjithashtu, orienton dhe ndihmon Bashkinë për përthithjen e fondeve dhe investimeve nga jashtë (donator) si dhe për të konkuruar me anë të projekteve për të aksesuar dhe tërhequr investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

- E treta, hartimi i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal shërben si iniciativë për fillimin e proceseve të planifikimit të territorit. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i kujdesshëm në mënyrë që ky dokument të përdoret më pas me hapat përkatës për hartimin e strategjisë dhe dokumentit të politikave si dhe më tej hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Gjithashtu, në mungesë të instrumentave vendore të planifikimit të territorit, ky dokument i shërben edhe si orientim për iniciativat private apo për politikat e bashkisë në lidhje me prioritetet për investim.

Në kontekstin e planifikimit të territorit, plani operacional për zhvillimin lokal nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor, por ndihmon në procesin e hartimit të tij. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i kujdesshëm që të shfrytëzojë procesin e hartimit të Planit

Operacional për Zhvillimin Lokal edhe si pjesë e procesit të vizionimit. Bashkia, tashmë ka të identifikuar disa prej problematikave më kryesore si dhe disa prioritetet zhvillimi. Edhe pse vizioni është ende në fillesat e hartimit të tij, përbën një bazë të mirë për të filluar hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit. Për të arritur në formulimin e strategjisë është e nevojshme që bazuar në prioritetet e përcaktuara në këtë dokument të elaborohen më tej politikat përkatëse sektoriale në mbështetje të vizionit dhe qëllimeve të zhvillimit.

Gjithashtu, janë përcaktuar edhe projektet prioritare për periudhën afat shkurtër të cilat mund të shërbejnë si shtytës të zhvillimit lokal. Bashkia, mund të ndërtojë në këto projekte dhe të zhvillojë më tej listën e projekteve strategjike e prioritare për një periudhë afatgjatë 10 vjeçare. Si rrjedhojë, procesi i hartimit të strategjisë territoriale, mund të fillojë brenda një harku kohor shumë të shkurtër, dhe duke përdorur si bazë Planin Operacional të Zhvillimit Lokal.

METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL

Bazuar në sa më sipër, grupi i konsulencës është munduar që të përshtasë metodologjinë e hartimit të POZHL në mënyrë të tillë që të shërbejë edhe për proceset e mëvonshme të planifikimit. Pra, procesi i hartimit të këtij plani të shërbejë edhe për ngritjen e kapaciteteve në planifikim si dhe si hap fillestar për hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit.

Metodologjia e hartimit të POZHL është bazuar kryesisht në metodën e 'planifikimit strategjik', duke e ndërthurrur atë dhe duke i kushtuar një vëmendje të veçantë edhe çështjeve të lidhura me raportin gjinor dhe pabarazitë gjinore. Janë përcaktuar një sërë indikatorësh për të kryer skanimin dhe diagnostikimin e problematikave kryesore të cilat has bashkia Peqin në aspektin administrativ, social, ekonomik dhe mjedisor. Gjithashtu, për të plotëuar mangësitë në të dhëna në indikatorë janë përdorur intervista gjysëm të strukturuara me grupe të ndryshme si dhe fokus grupe në kuadër të forumeve të zhvilluara në Bashki.

Me qëllim përgatitjen e planeve operacionale për zhvillimin lokal, të ndjeshme nga perspektiva gjinore është përdorur metoda e '4 R'. Respektivisht, R1 lidhet kryesisht me indikatorët e përfaqësimit të grave në aspekte të ndryshme të jetës sociale, institucionale, ekonomike e kulturore në Peqin. R2 lidhet me shpërndarjen e burimeve të përbashkëta paratë, koha etj. midis grave dhe burrave. R3- Lidhet me analizimin e kushteve mbi të cilat ngrihen çështjet e pabarazive gjinore. Ndërkohë R4- lidhet me realizimin dhe formulimin e objektivave e masave për ndërhyrjet dhe përmirësimin e situatës. Në këtë kontekst, të dhënat dhe diagnostikimi i problematikave gjinore është integruar në diagnozën e Bashkisë Peqin sipas tematikave përkatëse. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave kemi përdorur treguesit gjinore, të cilët kanë orientuar edhe diskutimet në forume, përcaktimin e prioritetëve, përgatitjen e fshave të projekteve dhe përgatitjen e planeve operacionale për zhvillimin lokal, të ndjeshme nga perspektiva gjinore.

Fillimisht, grupi i punës, ka filluar me grumbullimin e informacionit bazë në lidhje me Bashkinë Peqin. Kjo gjë është kryer duke mbledhur të dhëna nga burime të tjera të tilla si INSTAT, të dhëna të ministrive apo edhe raporte të mëparshme mbi Bashkinë Peqin. Pas krijimit të inventarit të të dhënave dhe njohjes së përgjithshme të Bashkisë, grupi i punës ka zhvilluar vizitën e parë në terren. Gjatë vizitës së parë, grupi është takuar me përfaqësues

të Bashkisë dhe me kryetarin e Bashkisë në mënyrë që të diskutoheshin dhe prioritetet e tij në lidhje me zhvillimin e territorit. Gjithashtu, në këtë kuadër është kontaktuar me Bashkinë në lidhje me plotësimin e të dhënave të cilat mungojnë. Për të krijuar një ide më të mirë mbi zhvillimin janë kryer dhe disa intervista gjysëm të strukturuara me banorë dhe aktorë të ndryshëm të Bashkisë. Më konkretisht, në Bashkinë Peqin, gjatë vizitës së parë u zhvilluan 20 intervista me banorët dhe grupet e interesit.

Në këtë kontekst u intervistuan 21 banorë/qytetarë nga të cilët 6 ishin të gjinisë femërore dhe 15 meshkuj. Kjo gjë vjen edhe si rrjedhojë e prezencës më të madhe të gjinisë mashkullore në rrugët dhe lokalet e qytetit. Gjithashtu u intervistuan 3 punonjës të administratës, respektivisht 1 femër dhe 2 meshkuj. U intervistuan 15 fermerë/biznese të cilat operojnë në zonë, nga të cilët 3 ishin të gjinisë femërore dhe 12 të gjinisë mashkullore. Edhe në këtë aspekt dallohej qartë një dominim i gjinisë mashkullore në ferma si dhe në biznese. Në fund u intervistuan dhe 3 ofrues të shërbimit të transportit, të cilët ishin të tre të gjinisë mashkullore.

Grupi i punës vijoi me hartimin e raportit të parë në lidhje me zonën, përcaktimin e problematikave dhe disa prej prioritetëve. Në këtë kontekst, si metodologji u përdor analiza S.W.O.T. Pas kësaj, u zhvillua forumi vendor. Ky u konceptua nga grupi i punës në kuadër të planifikimit strategjik, përcaktimit të prioritetëve dhe në fund projekteve kryesore. Për këtë gjë, në takimin me forumin vendor u krye prezantimi i të dhënave dhe i analizës S.W.O.T. Në takim morën pjesë rreth 30 veta, nga të cilët 23 meshkuj dhe 7 femra. Sërish u vu re mungesa e prezencës së gjinisë femërore, dhe shumi-ca e femrave që ishin të pranishme në takim ishin pjesë e Këshillit Bashkiak. Pas prezantimit nga grupi i konsulencës, takimi vijoi më tej me diskutime në fokus grupe për përcaktimin e problematikave, prioritarizimin, vizionin dhe në fund projektet e nevojshme. Duke qënë se Bashkia nuk ka iniciuar procese të tjera të planifikimit strategjik në forum u diskutua edhe për rëndësinë e një plani strategjik të hartuar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse i cili i përgjigjet nevojave të zhvillimit të Bashkisë. Në vijim, grupi i punës vazhdoi me plotësimin e raportit dhe të dhënave, prioritetëve e projekteve. Kjo gjë është bërë në diskutim të vazhdueshëm me përfaqësuesin e Bashkisë. Në fund, u zhvillua dhe forumi i dytë, final, ku u prezantua raporti përfundimtar dhe u morën komentet e rekomandimet e fundit.





DIAGNOZA PËR BASHKINË PEQIN

4.1 Të dhëna kryesore për Bashkinë Peqin

Bashkia e Peqinit pozicionohet në pjesën qendrore të Shqipërisë së Mesme. Kufizohet në veri me Tiranën, në jug me Lushnjën, në perëndim me Kavajën dhe Rrogozhinën, në lindje me Elbasanin dhe Belshin. Peqini zë një sipërfaqe prej 150km² dhe ka një popullësi prej 26,136 banorë.

Bashkia Peqin përbëhet nga 6 njësi administrative, përkatësisht: njësia Peqin, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë. Me ndarjen e vjetër territoriale dhe administrative, Bashkia Peqin ka pasur një territor prej 8.54 km² dhe një popullësi prej 8,934 banorë. Pas reformës territoriale dhe administrative Bashkia e Peqinit përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Peqin, Karinë, Pajovë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë. Bashkia Peqin, e cila ka qendër qytetin e Peqinit, dhe bën pjesë në qarkun e Elbasanit.

Në territorin e Bashkisë është më e përhapur tipologjia e banesës shtëpi (me 98.40%). Fluksi më i madh i ndërtimeve ka qënë prej vitit 1991 (48.7%) dhe pas vitit 2001 fluksi ka rënë në 23.39% banesa. Në pesë njësitë përbërëse, njësia Peqin mbizotëron për numrin e tipologjisë së banesave apartament (me 3.69% të banesave total), njësia Përparim nuk ka këtë lloj tipologjia, ndërsa të tjerat janë në nivelin të përafërt me 0.2%. Bashkia Peqin nuk e ka shumë të përhapur fenomenin e informalitetit, qendrat e banuara janë densifikuar brenda vetvetes dhe është ruajtur toka bujqësore.

Bashkia është një ndër qendrat kryesore të këtij rrethi, ku institucione si Zyra Arsimore, Zyra e Punësimit, Drejtoria Shëndetësore Rajonale, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Degët e Tatimeve në Rrethe, kryejnë aktivitetet kryesore të njësive administrative përbërëse. Pranë Bashkisë Peqin, ka një specialist të barazisë gjinore, i cili është përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore në Bashki dhe ka të përcaktuara qartë një numër detyrash dhe përgjegjësisht. Qendra sociale e personave me aftësi të kufizuara, dhe Forumi i gruas Elbasan, i cili mbështet gratë dhe vajzat e dhunuara, luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu Bashkia Peqin ka dy objekte, në të cilat ka ofruar strehimin falas për familjet në nevojë. Popullsia që i përket komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në këtë Bashki është 260 dhe 450 individë.

Financat e Bashkisë

Bashkia Peqin për vitin 2016 ka të parashikuar në projekt-ligjin për buxhetin një shumë totale prej 147,979 mijë

lekë. Nga këto, 106 886 mijë lekë janë të parashikuara si transfertat të pakushtëzuara. Ndërkohë, gjithashtu në lidhje me funksionet e reja të dhënave Bashkive janë bërë dhe përcaktimet e mëposhtme në buxhet të tilla si, arsimi parashkollor (31721 mijë lekë), (929 mijë lekë) arsimi parauniversitar, për mbrojtjen nga zjarri (3701 mijë lekë), për administrimin e pyjeve 613 mijë lekë dhe për rrugët 4121 mijë lekë.

Ndërkohë për vitin 2015 granti i akorduar nga qeveria për Bashkinë Peqin ka qënë 67.688.600 Lekë. Për 2015, Bashkia Peqin kishte të planifikuar si të ardhura të veta 46.471.667 lekë nga të cilat janë realizuar vetëm 31.590.488 lekë.




Figura 1: Bashkia Peqin dhe Njësitë Administrative Përbërëse


4.2 Zhvillimi Ekonomik

Lidhja Rajonale


Duke parë pozicionimin e Bashkisë Peqin në marrëdhënie me rajonin qendror, lexohet qartë që kjo ajo shtrihet në zonën kryesore të zhvillimit ekonomik. Përkatësisht, ndodhet midis poleve ekonomike qendrore, Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, pole të cilat jo vetëm janë të zhvilluara në vetvete dhe funksionojnë si një sistem (sidomos Zona Ekonomike Tiranë-Durrës), por gjithashtu janë motorri kryesor i sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së

Analizat dhe Vizionimi në shkallë Rajonale - Bashkia e Peqinit në Rajon


1. Orbitalet e Zhvillimit Territorial - Ndërthurja e Infrastrukturrës kryesore rrugore me qendrat e banuara dhe asetet natyrore





2. Potencialet Rajonale - Potencialet e ndryshme për zhvillimin e territorit, në përballje me rreziqet kryesore natyrore.



3. Karakteri i Zhvillimit- Ndërthyrja e aseteve të ndryshme natyrore me zonat ekonomike, krijimi i poleve të zhvillimit dhe i fashave territoriale. Sistemi kompleks, brenda së cilit Bashkia e Peqinit bën pjesë si një qendër e rëndësishme me karakter zhvillimi rural, bujqësor dhe pejzazhistik.



4. Dinamikat e Zhvillimit Rajonal - Performanca e Rajonit



Këtë pozicion e favorizon edhe fakti që Bashkia Peqin ndodhet në një nga unazat infrastrukturore më të fuqishme të vendit që lidh pikërisht polet ekonomike: Durrësin, Tiranën, Elbasanin, Kavajën dhe Rrogozhinën. Prania e rrugës nacionale e cila përshkon të gjithë Shqipërinë e mesme është një faktor pozitiv për aksesueshmërinë e zonës në tregje më të mëdha.

Duke qenë se Peqini gjendet midis 3 qyteteve më të rëndësishme të Shqipërisë, pikërisht midis Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit itineraret lidhëse midis tyre krijojnë mundësinë që Peqini të kthehet në një pikë të rëndësishme për të zhvillimin ekonomik dhe për t'u lidhur me tregje të ndryshme për të shitur në këtë mënyrë prodhimet e saj dhe të ulë kështu shkallën e varfërisë që njësi të ndryshme shfaqin. Pra, Peqini ka potencial për tu zhvilluar dhe të përmisojë dukshëm ekonominë e saj.

Figura 2: Lidhjet Strategjike të Bashkisë Peqin në Rajon (bashkangjitur në Aneks-in 2)

Sektorët kryesorë të ekonomisë

Bazuar në të dhënat e INSTAT, sektorët kryesorë ekonomikë në Bashkinë Peqin janë Bujqësia me 70% të të punësuarve, Industria me 7.2 % dhe Shërbimet me 22.8%. Kryesisht të punësuarit në shërbime janë pjesë e administratës publike, ose në sipërmarrje të vogla dhe të mesme brenda qytetit të Peqinit si dhe përgjatë rrugës nacionale Rrogozhinë-Pogradec.

Bujqësia në Bashkinë e Peqinit është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë dhe sektori me më shumë të punësuar. Ndonëse bujqësia e kësaj zonë është baza e ekonomisë nuk ka të dhëna të sakta për sa i përket prodhimit dhe rendimentit të tokave bujqësore. Peqini ka një sipërfaqe prej 8500 ha tokë bujqësore, ku kemi dhe një ndarje mjaft të mirë midis zonës fushore që ndodhet



Figura 3: Punësimi sipas Sektorëve

në qendër të territorit të Bashkisë dhe pjesës kodrinore e cila shtrihet në pjesën veriore e jugore të saj.

Kulturat më të mbjella në këtë zonë janë ulliri me 2991 rrënjë gjithnjë e në rritje, vreshtaria është gjithashtu një kulturë tepër e zhvilluar ku sipërfaqja e mbjellë është rreth 610 ha, ku kultivohen disa varjetete si: moskat, merlot, shesh i zi e i bardhë. Nga kultivimi i kësaj kulture gjithashtu prodhohen edhe nën produktet e saj si vera e rakia.

Për t'u përmendur është edhe kultura e misrit ku për shkak të përbërjes së tokës në këtë zonë ajo ka një rendiment të lartë dhe banorët e përdorin kryesisht për ushqim për bagëtinë. Drurët frutorë gjithashtu zënë një pjesë të madhe të të mbjellave siç janë: kumbulla, pjeshka, fiku, shega.

Për sa i përket blegtorisë edhe për shkak të klimës e terrenit ajo nuk është e zhvilluar sa bujqësia por mund të përmendim mbarështrimin e gjedhit të lopëve që janë në numër të konsiderueshëm dhe kanë potencial për zhvillim të mëtejshëm. Gjithashtu Peqini njihet për mbarështrimin e shpendëve e saktësisht të Gjelit të Detit i cili është edhe një nga produktet identifikuese të Bashkisë.

Llojet dhe përqëndrimi i bizneseve

Para viteve '90 në zonën e Peqinit zhvilloheshin kryesisht aktivitete ekonomike bazuar në bujqësi-blegtori dhe industri (agroindustri dhe ajo e materialeve të ndërtimit). Fabrikat e produkteve ushqimore, kantjeret e inerteve dhe ndërmarrjet e zdruktharisë përbënin bazën ekonomike.

Ndryshimi i sistemit solli edhe braktisjen dhe shkatërrimin e strukturave të tyre. Sot aktiviteti ekonomik që zhvillohet është i ndryshëm sektorët më të rëndësishëm në ekonominë e qytetit janë ato të ndërtimit dhe të shërbimeve ndërsa në njësitë e tjera bujqësia.

Këto sektorë mbulojnë dhe numrin më të madh të të punësuarve në qytetin e Peqinit, përjashtuar të punësuarit e administratës. Në sektorin e bujqësisë punojnë 70% e të punësuarve (numërin më të lartë të të punësuarve në sektorin bujqësor e ka njësi Gjocaj me 88.8%, ndërsa më të voglin njësi Peqin me 4.8%), sektori i industrisë mbulon 7.2% (numërin më të lartë të të punësuarve në sektorin e industrisë e ka njësi Peqin me 17.6%, ndërsa

LEGJENDA:



PEMISHTE

e perhapur ne zonat kodrinore te fokusuar ne Gjocaj, Karine, Pajove
Kultivohen varietet frutash dhe agrumesh

ULLISHTE

2991 ha
te shperndara ne te tere territorin, kryesisht ne Gjocaj
Druri me i mbjelle

VRESHTA

610 ha
te fokusuar ne njesine Karine, Gjocaj, Sheze
Varietete te ndryshme



Figura 4: Kulturat Kryesore Bujqesore

më të ultin njësia Gjocaj me 2.3%).

Ndërsa rritje ka pasur sektori i shërbimeve me 22.8% të të punësuarve (numrin më të lartë të të punësuarve në sektorin e shërbimeve e ka njësia Peqin me 77.56%, ndërsa më të ultin njësia Gjocaj me 8.87%).

Bizneset janë kryesisht të përqëndruara në shërbime kryesore të nevojshme për jetën e përditshme të banorëve. Duke iu referuar përqëndrimit të bizneseve dhe shumëllojshmërisë së aktivitetit të tyre (i cili indirekt dëshmon për nivel më të lartë të shërbimeve), Bashkia Peqin, është një ndër katër zonat funksionale në qarkun e Elbasanit me qendër njësinë Peqin, dhe në rang rajoni kjo lidhje është më e forta ekonomike. Kjo njësi është më e drejtuar drejt sektorëve të shërbimeve dhe industrisë, ndërsa njësitë Gjocaj, Përparim dhe Shezë drejt bujqësisë. Dy njësitë e tjera Karinë dhe Pajovë përveç sektorit bujqësor kanë filluar të orientohen edhe drejtë sektorit të shërbimeve.

Elementë të fortë territorialë dhe ekonomikë

Fakte për t'u mos u neglizhuar janë edhe prania e hekurudhës dhe rrugës Egnatia. Hekurudha, e cila kalon përgjatë aksit perëndimor-lindor të territorit të Bashkisë së Peqinit, pavarësisht potencialit të madh që paraqet, sot fatkeqësisht ndodhet jashtë funksionit.

Rruga Egnatia, ka qenë një ndër rrugët më të rëndësishme romake, kalon gjithashtu paralel me hekurudhën dhe pikërisht në Peqin, ka qenë një ndër stacionet më të rëndësishme të itinerarit ekonomik që kryej në ato

kohë. Fakt ky, që tregon rëndësinë që ka pasur Peqini jo vetëm për banorët e tij, por për gjithë rajonin, ka qenë një ndalesë e rëndësishme ekonomike.

Në ditët e sotme, bazë e ekonomisë së Bashkisë së Peqinit ndihet dukshëm që është bujqësia. Territori i Bashkisë dallohet për tokat bujqesore të cilat favorizohen nga lloji i klimës dhe prania e lumit Shkumbin. Tokat bujqesore zënë rreth 8500 ha ku shtrihen përkatësisht në njësitë Gjocaj, Karinë dhe Pajovë. Peqinasit dallohen për prodhimin e vajit të ullirit dhe punishtet e tyre. Gjitashtu prodhojnë rrush, drithëra dhe drurë frutorë. Drurët frutorë zënë pjesën më të madhe në bujqësinë e zonës dhe kryesisht ato gjenden në zonat kodrinore siç janë: kumbulla, pjeshka, fiku, shega, mandarina, portokalli etj. Produktiviteti i lartë në këtë zonë përbën një potencial për zgjerimin e zinxhirit të vlerës (value chain) së produkteve bujqësore. Si rrjedhojë, ky potencial mund të shfrytëzohet më mirë duke rritur e promovuar kapacitete vendore në prodhimin dhe përpunimin e reçelrave, pijeve etj.

Përpunimi mund të zhvillohet në dy mënyra si ai artizanal, duke ndihmuar në çertifikimin dhe marketimin e produkteve vendase, ashtu dhe në atë industrial ku bashkia Peqin mund të aplikojë politika mbështetëse për industrinë e përpunimit agro-industrial. Ky potencial i prodhimit dhe përpunimit të reçelrave, pijeve etj përbën një mundësi për punësimin e të rinjve, të rejave, grave, etj. Në të dyja aspektet duhet të mbahet gjithnjë në konsideratë balanca gjinore në punësim dhe të promovohet gjithashtu dhe punësimi tek të rinjtë.

Figura 5: Elementët e Fortë Territorialë dhe Ekonomikë (bashkangjitur në Aneks-in 2)

4.3 Mirëqënia Sociale dhe Ekonomike

Demografia

Popullsia në Peqin është 26136 banorë referuar Censurit dhe 37173 banorë sipas Regjistrimit Civil. Dendësia është rreth 1690 b/km². Raporti i popullsisë urbane-rurale është 32.1%, që tregon për një dominancë të popullsisë rurale e cila është dhe më e lidhur me tokën dhe punimin e saj. Pjesa urbane gjendet e fokusuar në njësinë Peqin dhe janë të orientuar kryesisht drejt ofrimit të shërbimeve.

Struktura moshore tregon që Bashkia e Peqinit ka një potencial për zhvillimin ekonomik pasi 71.8% (njësia Peqin max.) -68.10% (njësia Karinë, Përparim min.) janë nga moshë 15-65 vjeç. Në fjalë të tjera, është një popullsi aktive që mund të aktivizohet në punësim.

Nga të dhënat, 31% e popullsisë është në moshën 0-18 vjeç ndërsa 69% e popullsisë është mbi moshën 18 vjeç. Popullësitë e Bashkisë Peqin, sipas njësive administrative përbërëse:




Figura 6: Popullsia sipas Njësive Administrative

Prej këtyre, 10980 janë femra dhe 13512 janë meshkuj. Personat me aftësi të kufizuara: 863 femra dhe 691 meshkuj.



Figura 7: Popullsia sipas Moshës dhe Gjinisë

Mirëqënia ekonomike

Bashkia e Peqinit nuk përfshihet në qendrat kryesore të zhvillimit të vendit dhe ekonomia e saj është më e lidhur me resurset natyrore. 70% e banorëve janë të punësuar në bujqësi ndërsa pjesa tjetër në shërbime dhe industri.

Por papunësia është një ndër problemet kryesorë, ku 21.2% e popullsisë janë të regjistruar si të papunë (problematika më e madhe vihet re tek punësimi i të rinjve dhe femrave). Njësia më problematike është njësia Peqin (55.30% e popullsisë). Papunësia e femrave arrin 23% por më problematike është ajo e të rinjve me 40.9%.

Standartet e jetesës përta i përket furnizimit me ujë dhe lehtësirave të tjera, janë poshtë mesatares së vendit pasojë kjo edhe e të ardhurave të pakta familjare, ku 9.8% janë me asistencë, 18.6% mbahen nga të ardhurat e emigrantëve, 29.3% me pensione dhe 68.8% kanë pagë.




Figura 8: Niveli i të Ardhurave dhe Numri i Personave të Papunë

4.4 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore

- **Lumi Shkumbin**, i cili kalon në të gjithë gjërësinë e territorit të Bashkisë së Peqinit, e favorizon shumë këtë territor, sidomos nga ana natyrore. Prania e këtij lumi bën që të ketë dhe sasi të madhe të ujit në këto zona, që mund t'i përdorin për qëllime të ndryshme sidomos për ujitjen dhe vaditjen e kulturave bujqësore.

- **Klima**, e cila ka karakter mesdhetar me dimër të butë me shira, dhe verë të nxehtë e të thatë. Bimësinë e zakonshme e përbëjnë shkurret dhe pyjet përherë të gjelbra. Në brendësi të territoreve ajo ndryshon në varësi të relievit duke ashpërsuar karakteristikat e saj.

- **Tokat** në territorin e Bashkisë Peqin përbëhen nga toka livadhore të hinjta /kafe dhe toka të hirta kafe. Toka livadhore të hinjta / kafe ndodhen mbi tokat aluvionale, kanë cilësi të mira fizike (përshkueshmëria, porozitet, plasticitet e cilësi të mira ujore). Janë të mira për kultivimin e vreshtave e kultivareve, drufrutore.

Tokat e hirta kafe kanë cilësi fizike të mira. Kjo lidhet me përmbajtjen e lartë të humusit dhe të karbonit të kalçiumit. Këto toka kanë porozitet dhe ajrim shumë të mirë. Janë tokat me pjellore dhe gjenden në ultësirën Perëndimore.

Mbulesa e Tokës

Përhapjen më të madhe në Peqin e kanë tokat bujqësore (të gjendura kryesisht në zonat fushore afër lumit Shkumbin) dhe kullotat (në zonat kodrinore). Zona kodrinore mbulohet me pyje si: lis, dushk, thanë, shkozë, bli etj.

Në vitet 70 një pjesë e kodrinave u kthyen në tarraca për mbjelljen e ullinjve vreshta e dru frutore. Kurora e gjelbërt përfaqësohet nga pylli i ullishteve në Germenj të Karines, Pajovë.

Zona e pyjeve shtrihet kryesisht përgjatë kodrave të Darsisë. Zona e Peqinit ka një sipërfaqe prej afërsisht 4 mije hektarë pyje ku kryesisht mbizotërojnë shkurret të cilat kanë krijuar habitate të pershtatshme për zogjtë.

Pasuritë Nëntokësore

Ka rezerva nafte në Pekisht që shfrytëzohet prej 70 vitesh. Shtrati i lumit njihet për rrëën e zhavorin tepër cilësor i cili mund të përdoret për ndërtim. Burimet sulfurore të

Fibaltës ndodhen midis Rrogozhinës dhe Peqinit rreth 200 m larg shtëpive të fshatit Karinë. Temperaturat e ujit që dalin prej tij janë më të larta se temperatura e ambientit dhe në të janë gjetur edhe rrënojat e një burimi të hershëm ku mendohet të ketë qenë ambient për shrytëzimin e këtij uji për qëllime kurative.

Ndotje ujit, ajrit, tokës dhe ndotje të trashëguara

Nuk ka studime të mirëfillta të kryera nga Ministria e Mjedisit, por Peqini nuk konsiderohet një qytet problematik për sa i përket këtyre faktorëve. Për sa i përket zonave të ndotura të trashëguara nuk mund të evidentohet ndonjë sipërfaqe e veçantë. Territori i bashkisë nuk ka zona të tilla, kjo sepse në këtë bashki nuk kanë ushtruar funksionin e tyre ndonjë industri ndotëse.

Sipas Agjensise Rajonale të Mjedisit Elbasan një nga shkaqet kryesore të ndotjes së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore janë veprimet e industrive dhe mos trajtimi i ujrave të zeza. Pjesa më e ndotur në Bashkinë Peqin është segmenti i Shkumbinit që kalon në anën jugore të qytetit pasi aty bëhet edhe derdhja e ujrave të zeza pa trajtim gjithashtu shkak tjetër i ndotjes janë edhe mbetjet spitalore.

Një tjetër problematikë e rrjetit të kanalizimeve është dhe bashkimi i ujërave të mbetura spitalore dhe industriale me ujërat e përdorura të qytetit, duke e rrezikuar ende me shumë ndotjen e lumit Shkumbin.

Në vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i mjeteve që qarkullojnë në Bashkinë Peqin 1579. Nuk ka të dhëna të sakta për ndotjen e shkaktuar nga automobilat vetëm për Bashkinë Peqin por meren si bazë të dhënat për qarkun e Elbasanit.

Për Transportin, trafiku rrugor është përgjegjës për rreth 30-60% të emertimeve të oksidëve të azotit (Nox), 40-90% të monoksidit të karbonit, 35-95% të emetimeve të grimcave, dhe më pak se 5% të emetimeve të dioksidit të squfurit.

Figura 9: Harta e Rrjetit Hidrografik
Figura 10: Harta e Tokave
(të bashkangjitura në Aneks-in 2)

4.5 Shërbimet dhe Infrastruktura

Edukimi

Oftohen institucione arsimore të tre shkalleve dhe të ndara në zona urbane dhe rurale dhe ka të regjistruar gjithsej 8953 fëmijë (bazuar në të dhënat e vitit 2011). Për- sa i përket popullsisë 15645 persona kanë mbaruar arsimin 8-9 vjeçar, 4235 janë me arsim të mesëm dhe 860 me arsim të lartë. Nga vëzhgimet në terren dhe raportet e publikuara më parë, peqini ka këto karakteristika:

- Në nivel qarku Peqini në raport edhe me popullsinë ka shifra të vogla
- Ka një nivel të mirë të regjistrimit në arsimin e detyruar
- Ka nivel të lartë të braktisjes të arsimit të mesëm, duke pasur pjesëmarrjen më të ulët në nivel qarku.



Figura 11: Niveli i Arsimit sipas Sektorëve

Për- sa i përket braktisjes së arsimit të mesëm, kjo gjë vihet re veçanërisht në zonat rurale. Nga të dhënat dallohet dhe një shkallë e lartë analfabetizmi. Mungesa e aktiviteve edukative pas-shkollore dhe roli i dobët i qendrës kulturore ndikojnë gjithashtu në nivelin e arsimit dhe të braktisjes së shkollës. Kjo problematikë vërehet edhe tek femrat, ku nga intervistat, për shkak edhe të çështjeve të mentaliteti nuk vijojnë me formimin e mëtejshëm akademik.

Gjithashtu në Bashkinë Peqin mungojnë mundësitë për formim profesional si dhe për trajnimin e të rinjve në profesione të ndryshme bazuar në kërkesat e tregut të punës së zonës.




Figura 12: Nr. i Nxënësve dhe Mësuesve në Zonat Rurale dhe në Total

Kujdesi Shëndetësor

Njësia Peqin ka vetëm një spital në të cilin funksion- ojnë :

- Reparti i patologjisë, i cili ka një kapacitet me 12 shtretër
- Reparti i Pediatrisë, i cili ka një kapacitet me 12 shtretër
- Reparti i maternitetit, i cili ka një kapacitet me 8 shtretër

Njesia gjithashtu ka edhe një poliklinike qendrore në të cilën përfshihen:

- Shërbimi i mjekut të familjes;
- Konsultori i gruas;
- Konsultori i fëmijës;
- Reparti i mjekim –injeksioneve;
- Laboratori kimik –Biokimik e Bakteriologjik;
- Radiologu dhe Kimisti Ushqimor;
- Shërbimi i Higjenës dhe Epidemiologjisë.

Sipas të dhënave të Spitalit :

1. Raporti Mjek – Banorë, është 1 mjek në 1,400 banorë;
2. Pothuajse i gjithë spitali dhe poliklinika janë rikon- struktuar dhe kushtet e objekteve janë të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin.

Sipas të dhënave nga anketimi:

1. Aparate jo të përshtatshme (87,7 % e të anketuarve)
2. Para nën dorë (53,8 % e të anketuarve)
3. Cilësi e dobët e shërbimit (27,7 % e të anketuarve)
4. Kushte jo të përshtatshme (9,3 % e të anketuarve)

Rrjeti elektrik

Qyteti i Peqinit furnizohet me energji elektrike nga Nst/ Përparim (35/10 kv;1x5600 kva) nëpërmjet linjës ajrore të tensionit të lartë 10 kv, me gjatësi 5 km. Numri i kabinave në qytetin e Peqinit është 24. Fuqia e instaluar e kabinave është 800 kva.

Rrjeti ekzistues tejet i amortizuar sjell probleme në furnizimin me energji në mënyrë të rregullt, ka ndërprerje të energjisë në kohë fluksi. Për këto arsye duhet të bëhet një remont total i linjës ekzistuese edhe shtim kapaciteti gjithashtu duhet të ndërtohen kabina të reja elektrike me transformator më të mëdhenj. Rrjeti ekzistues arrin të mbulojë me energji vetëm banesat ekzistuese e jo ato informale që janë ndërtuar ndër vite. Gjithashtu, edhe përsa i përket njësive administrative rrjeti elektrik është i dobët dhe i amortizuar. Në disa raste shkakton ndërprerje të energjisë elektrike.

Ndriçimi rrugor

Për sa i përket ndriçimit rrugor mund të themi se ai nuk është në nivele të kënaqshme pasi vetëm bulevardi kryesor dhe disa rrugica kryesore janë të pajisura me shtylla ndriçimi pra duke lënë pjesën tjetër të qytetit pa ndriçim urban. Një nga problemet e tjera që e shoqeron këtë shërbim është amortizimi i këtij rrjeti pasi shërbimet nuk kryhen rregullisht. Ndërkohë, për njësitë administrative rrjeti i ndriçimit rrugor është pothuajse inekzistent.

Rrjeti KUZ

Gjatësia totale e K.U.Z është rreth 5,931 km. Mungon krejtësisht impjanti i përpunimit të ujërave të zeza, çka çon sot në ndotjen e lumit Shkumbin nga K.U.Z. të cilët shkarkohen drejtpërdrejt në lum.

Një tjetër problematikë e rrjetit të kanalizimeve është dhe bashkimi i ujërave të mbetur spitalore dhe industriale me ujërat e përdorura të qytetit, duke e rrezikuar edhe më shumë lumin Shkumbin.

Shumica e rrugëve të qytetit, sidomos ato të paasfaltuara nuk kanë infrastrukturë nëntokësore dhe si rrjedhojë dhe K.U.Z.

Zonat periferike të qytetit, zonat informale dhe ato zona me perspektive zhvillimi nuk janë pajisur me rrjetin e K.U.Z.-se dhe sot kryesisht funksionojnë me gropa sepike.

- Rrjeti nuk mbulon të gjithë sipërfaqen e Bashkisë me shërbim të KUZ.
- Rrjet tejet i amortizuar, nevojë për rinovim shtim kapaciteti.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Qyteti i Peqinit furnizohet me ujë sot nga pus shpimet buzë lumit Shkumbin me ngritje mekanike. Stacioni i pompimit së bashku me tubacionin e dërgimit janë ndërtuar në vitin 1986. Aktualisht në këtë stacion shfrytëzohen 2 pus shpime ku sëbashku kanë një prurje prej 24 l/sek ndërsa dy pus shpime të tjera janë të pashfrytëzuara për shkak se janë të bllokuara që në hapjen e tyre ku kanë një prurje prej 15 l/sek.

Tubacioni i dërgimit është i amortizuar pasi është i vjetër por edhe nga ndërhyrjet e paligjsme që janë kryer në të. Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të qytetit Peqin është ndërtuar në vitin 1966. Qyteti furnizohet me ujë reth 2 orë në ditë 1 orë në mëngjes dhe 1 orë në mbrëmje të cilat nuk plotësojnë nevojat e popullatës.

Gjatë viteve janë bërë rikonstruksione në disa tubacione por përsëri janë tepër të vogla për nevojat e rrjetit, nga degradimi i tubacioneve vende-vende ato janë bashkuar edhe me tubacionet e ujrave të zeza gjë që e bënë ujin jo të pijshëm.

Puset e këtyre burimeve furnizojnë me ujë rezervuarin kryesor të qytetit, i cili ndodhet tek spitali i qytetit (Kodra e Topit) me kapacitet 1300m3, ndërsa burimi i ujit tek ura e vjetër furnizon një rezervuar 500 m3 tek kodra e Shegëve (ish ekstraksioni).

Konsumatorët më të mëdhenj të ujit janë familjarët dhe institucionet publike, ndërsa për sa i përket vjeljes së taksës është në nivele të kënaqshme por nuk kap kuotën e 100% të arkëtimit.

- Rrjeti i furnizimit me ujë nuk mbulon të gjithë sipërfaqen e Bashkisë;
- Uji në shumicën e rasteve është i ndotur, gjë që mund të sjellë probleme shëndetësore;
- Rrjeti i shpërndarjes dhe i grumbullimit të ujit është i amortizuar;
- Orare të kufizuara në furnizimin me ujë;
- Mangësi në vjeljen e taksës për ujin.

Rrjeti telefonik

Shërbimi telefonik fiks kryhet nga Albtelekom Sh.A Peqin. Përpara vitit 2000 qyteti i Peqinit kishte një numër të kufizuar telefonatash shërbimi, që ishin kryesisht familjare dhe të institucioneve, rreth 940 numra në përdorim.

Në vitin 2001 u bë implementimi i një çentrali dixhital tip RSU me 1920 numra, i cili plotësoi në masë të konsiderueshme kërkesat e familjarëve, ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore, firmave private për numra telefoni.

Në vitin 2003 u ndërtua rrjeti i ri kabllor urban brenda kushteve dhe parametrave teknike. (IN-08). Përveç telefonisë fikse ofrojnë shërbimin e tyre edhe kompanitë private: Vodafone, T mobile, Eagle, Plus.

Rrjeti i telefonisë fikse funksionon në tre nivele, përkatësisht:

- Rrjeti i parë kalon nëpër kanale dhe tubacione nëntokesore, të cilat kontrollohen me anë të pushtave të kontrollit;
- Rrjeti i dytë është një rrjet nëntokësor i shtrirë direkt në tokë, si dhe ajror;
- Rrjeti i tretë nënkupton linjat që shpërndahen nga Dp (Kasetat) tek abonenti.

75% e baorëve të Peqinit janë të lidhur me telefoninë fikse.

Mbetjet Urbane

Mbledja e mbetjeve urbane ofrohet si shërbim në territorin e Bashkisë Peqin kryesisht në qendrën e qytetit dhe fshatrat për-rreth saj, problematike paraqiten zonat periferike të bashkisë për shkak se edhe makinat që ofrojnë këtë shërbim e kanë të vështirë të futen në ato zona. Në mënyrë të përafërt sasia e mbetjeve që mbledhet është 20 ton\ditë me një mesatare vjetore 6570 ton\vit.

Pika e grumbullimit të mbetjeve urbane është miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim Nr 71 dt 18.12.2000 të ish poligoni i vjetër. Kjo pikë shtrihet 500m mbi qendrën e qytetit. Në këtë vend depozitim nuk bëhet ndarja dhe përpunimi i mbetjeve urbane, problematika e kësaj bashkie është edhe mungesa e një vend depozitimi për mbetjet inerte.

Deri në fund të vitit 2007 e në vazhdim në Bashkinë e Peqinit pastrimi kryhet nga Ndërmarrja Shtetërore Komunale. Kjo ndërmarrje bën pastrimin e të gjithë rrugëve të

qytetit, si dhe freskimin e rrugëve në muajt qershor, korrik, gusht, shtator si dhe largimin e plehrave.

Në total shërbimi i pastrimit dhe i tërheqjes së plehrave i ofrohet 2650 familjeve.

Aktualisht tarifa për familjarët është 300 lekë/vit; për biznesin e vogël (që kryen shërbime) është 15.000 lekë/vit dhe për biznesin e vogël (që kryen tregëti) tarifa është 15.000 lekë/vit; për biznesin e madh (që kryen shërbim dhe ka TVSH) tarifa është 30.000 lekë/vit ndërsa për biznesin e madh (si firmat e ndërtimit) është 60.000 lekë/vit.

Shërbimi i transportit

- Transporti automobilistik

Shërbimi i transportit publik në qytetin e Peqinit fillimet e saj i ka që në vitin 1994. Ky shërbim ndërqytetas realizohet nëpërmjet automjeteve private, linjave të autobuzeve dhe furgonave (8+1) si dhe më pak shërbimi hekurudhor. Linjat e autobuzeve që funksionojnë në qytetin e Peqinit janë: Peqin - Tiranë, Peqin - Fier, Peqin - Elbasan dhe ky shërbim kryhet nga 7 autobusë.

Funksionojnë gjithashtu dhe linjat e autobusëve që lidhin qytetin e Peqinit me 5 njësitë administrative që janë: Gjoçaj, Karinë, Përparim, Pajovë dhe Shezë, shërbim ky i kryer nga 3 autobusë. Gjithashtu ky shërbim u vjen në ndihmë dhe arsimtarëve që punojnë në këto zona.

Përsa i përket shërbimit taksi me mikrobuza, ky shërbim është i ngjashëm me shërbimin e autobusëve por ky shërbim është më i shpejtë dhe i përgjigjet njerëzve në çdo kohë. Në këtë shërbim janë 11 furgonë (taksi). Lëvizja brenda qytetit për shkak edhe të madhësisë së vogël të qytetit kryhet me këmbë ose biçikleta. Numri total i automjeteve është 1570.

- Transporti hekurudhor

Si rezultat i pozitës së favorshme gjeografike, Peqini është edhe një nyje e rëndësishme e transportit hekurudhor dhe është i lidhur me hekurudhë. Ky transport siguron lëvizje të udhëtarëve dhe mallrave me kosto më të ulët.

Sipas të dhënave të stacionit të trenit në Peqin, nëpërmjet transportit hekurudhor, vetëm nga Peqini në periudhën e dimrit lëvizin mesatarisht 50 udhëtarë në ditë, ndërsa në

periudhën e verës lëvizin 120 udhëtarë në ditë. Transporti hekurudhor ofron një shpejtësi lëvizjeje afërsisht 35 – 40 km/orë. Kostoja e transportit hekurudhor është 2 – 3 herë më e ulët për udhëtarët, ndërsa kostoja e transportit të mallrave është 7 – 9 lek ton/km.

Figura 13: Harta e Institucioneve Arsimore

Figura 14: Harta e Institucioneve Shëndetësore

Figura 15: Harta e Furnizimit me Ujë të Pijshëm

Figura 16: Harta e Kanalizimeve të Ujërave të Zeza

*Figura 17: Harta e Infrastrukturës Kryesore Rrugore
(të bashkangjitura në Aneks-in 2)*



4.6 Konkluzione

Pas diagnostikimit të disa prej çështjeve më kryesore të bashkisë Peqin, grupi i punës ka zhvilluar analizën S.W.O.T dhe më pas ka gjeneruar ‘pemën e problemeve’ për bashkinë. Në analizën S.W.O.T janë përfshirë dhe elementët e

barazisë dhe çështjeve gjinore në mënyrë që të ketë një përfaqëse sa më të integruar të të gjithë komponentëve. Të dyja këto aspekte janë përdorur për të ofruar propozime konkrete dhe projekte për zhvillimin e mëtejshëm.

SWOT| Infrastruktura

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)
- Akses i mirë falë afërsisë me rrugët kombëtare (Durrës-Vlorë) dhe kalimit në territorin e saj të rrugës kombëtare Durrës-Elbasan-Pogradec; - Prania e hekurudhës që përshkon territorin e bashkisë (filon nga Durrësi dhe përfundon në Pogradec); - Afërsia me aeroportin Nënë Tereza, portin e Durrësit dhe kufirin me Maqedoninë.	- Cilësi e dobët e infrastrukturës dhe mungesë aksesibiliteti që lidh qytetin e Peqinit me fshatrat; - Mungesë e ndriçimit rrugor ul shkallën e sigurisë veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë; - Mungesë e ndriçimit rrugor; - Mungesë e infrastrukturës së dedikuar për personat me aftësi të kufizuar (të shumtë në numër); - Mungesa e një terminali për të kryer shërbimin e transportit publik.

SWOT| Bujqësia dhe Blegtoria

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)
- Sasia dhe boniteti i tokave bujqësore në territorin e bashkisë krijon bazën për zhvillimin ekonomik të familjeve dhe bashkisë; - Tradita e punimit të tokës, banorët historikisht janë marrë me punimin e tokës; - Fondi ekzistues i ullishteve, vreshtave dhe drurëve frutorë; - Karakteristike e Peqinit, mbarshtrimi i gjelit të detit.	- Mungesa e tregjeve të konsoliduar në territorin e bashkisë; - Mungesa e infrastrukturës bujqësore mbështetëse (pika magazinimi dhe ato frigoriferike); - Kushte të dobëta e infrastrukturave vaditëse; - Mungesa e projekteve/politikave për mbështetjen e fermerëve, dhe të përfshirjes së grave dhe të rinjve në zinxhirin ekonomik të produkteve; - Mos punimi i tokës si pasojë e mungesës së kushteve teknologjike

SWOT| Mjedis

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)
- Peizazh i padëmtuar natyror; - Nuk ka probleme mjedisore të theksuara;	- Ndotja e lumit Shkumbin nga aktiviteti njerëzor (bujqësor dhe industrial); - Mungesa e një impianti për

SWOT| Gjendja Social-Ekonomike

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)
- Lëvizje e vogël e popullsisë në territorin e Bashkisë; - Mosha e re mesatare e popullsisë, tregues për banorë të	- Ndarje e theksuar gjinore. Edhe si pasojë e mentalitetit, femrat nuk janë të përfshira në jetën social kulturore;

SWOT| Mjedisi (vazhdim)

— - Mjedisi i pastër i territorit të bashkisë Peqin.	— - përpunimin e ujërave të zeza; - Trajtimi i mbetjeve urbane jashtë standardeve; - Mungesa e riciklimit dhe infra-strukturës për ta realizuar; - Pikat e nxjerrjes së inerteve legale dhe ilegale në shtratin e Shkumbinit; - Mos mbulimi i të gjithë territorit nga shërbimi i mbledhjes së mbetjeve urbane.
---	--

SWOT| Gjendja Social-Ekonomike (vazhdim)

— - aftë për punë; - Popullsi vendase homogjene, kulturë dhe tradita të njëjta; - Aplikimi i politikave mbështetëse për përfshirjen e grave dhe të rinjve në bujqësi dhe agro-përpunim; - Mundësia e rivitalizimit të Qendrës Kulturore me qëllim gjithpërfshirjen sociale me fokus të veçantë tek problemet gjinore dhe të rinjtë; - Akses të mundshëm në fonde për përmirësimin e kushteve të shërbimit shëndetësor dhe plotësimi me aparaturë të nevojshme, si aparate mamografie, konsultore për nënat dhe foshnjat etj...	— - Numri i pakët i nxënësve që frekuentojnë shkollën e mesme; - Numri i lartë i të papunëve, veçanërisht tek të rinjtë dhe tek gjinia femërore; - Përfaqësim i vogël i grave në administratë dhe institucione publike; - Mungesë e institucioneve në mbështetje të grave; - Roli i dobët (shumë i vogël) i qendrës kulturore në organizimin e aktiviteteve gjithpërfshirëse; - Aftësi e ulët për grumbullimin e taksave dhe gjenerimin e fondeve; - Mungesa e politikave të strehimit social.
---	---

SWOT| Turizmi

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA) — - Trashëgimia historike (Kalaja, Kulla e sahatit, Rruga Egnatia); - Monumente natyrore dhe kulturore të shpërndarë në të gjithë territorin e bashkisë së Peqinit.	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA) — - Mungesa e promovimit të aseteve të bashkisë së Peqinit; - Mungesë investimesh në përmirësimin e imazhit të qytetit; - Mosmirëmbajtja e monumenteve natyrore dhe kulturore.
---	---

SWOT| Mundësitë dhe Rreziqet

3 OPPORTUNITIES (MUNDËSITË) — - Promovim më i mirë nga bashkia i aseteve të saj kulturore e turistike; - Rivitalizimi i Qendrës Kulturore me qëllim gjithpërfshirjen; - Promovimi i vlerave sportive; - Përdorimi i ish godinave industriale për qëllime tregtare; - Promovim i prodhimeve bujqësore gjatë tregjeve të reja; - Shfrytëzimi i kalasë për qëllime tregtare e sociale; - Promovimi i agro-turizmit; - Pozita gjeografike midis tre poleve kryesore ekonomike.	4 THREATS (RREZIQET) — - Shtimi i papunësisë për shkak të mungesës së politikave për zhvillimin e ekonomisë; - Rritja e analfabetizmit; - Theksimi i ndarjes gjinore mos përfshirja e femrave në aktivitete e punësim; - Përmytjet nga lumi Shkumbin; - Probleme mjedisore të cilat mund të shkaktohen nga degradimi i pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane; - Pikat e nxjerrjes së inerteve formale dhe informale; - Dëmtimi i peizazhit natyror për shkak të fenomenit të erozionit dhe ndërhyrjes së njeriut në natyrë.
--	---

PROBLEMATIKAT DHE PRIORITETET



5.1 Problematikat dhe Prioritetet

Bazuar në analizat e mësipërme, si dhe në ‘pemën e-problematikave’ (bashkangjitur në Aneks-in 2), grupi i punës ka identifikuar problematikat më të rëndësishme, me të cilat përballlet Bashkia e re e Peqinit, duke rekomanduarmë tej prioritetet si më poshtë:

PROBLEMATIKA



ORGANIZIMI INSTITUCIONAL-ADMINISTRATIV

- Mungesa e dokumentave të planifikimit të territorit dhe kapaciteteve vendore në planifikim;
- Burimet Financiare të Bashkisë janë të limituara dhe nuk arrijnë t'i përgjigjen problematikave vendore.

PRIORITETE

Ngritja e Kapaciteteve vendore në menaxhimin, planifikimin dhe zhvillimin e territorit

- Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor;
- Ngritja e Kapaciteteve Lokale në planifikim dhe menaxhim territori.



ZHVILLIMI EKONOMIK

- Mungojnë tregjet e bujqësisë
- Rrjeti i Kullimit dhe Vaditjes është i dëmtuar
- Ekonomia e bazuar kryesisht në sektorin e bujqësisë
- Nuk shfrytëzohen potencialet e tjera natyrore, kulturore e historike

Diversifikimi i Ekonomisë dhe Zhvillimi Ekonomik:

- Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë dhe mbështetja e sipërmarrjeve të reja lokale;
- Rritja e vizibilitetit, aksesueshmërisë në tregje dhe promovimi i produkteve lokale;
- Diversifikim dhe specializim i ekonomisë me fokus më të madh në turizmin agro-turizëm dhe itinerare natyrore e historike.



SHËRBIMET DHE MJEDISI

- Rrjeti Kanalizimeve nuk mbulon të gjithë sipërfaqen e Bashkisë me shërbim të KUZ dhe si rrjedhojë ndotet lumi Shkumbin dhe tokat bujqësore. Rrjet tejet i amortizuar, nevojë për rinovim shtim kapaciteti;
- Rrjeti i furnizimit me ujë nuk mbulon të gjithë sipërfaqen e bashkisë;
- Uji në shumicën e rasteve nuk është baktereogjikisht i pastër çka mund të sjelli probleme shëndetësore;
- Rrjeti i shpërndarjes dhe i grumbullimit të ujit është i amortizuar;
- Orare të kufizuara në furnizimin me ujë;
- Shërbimit i menaxhimit të mbetjeve nuk ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë;
- Venddepozitimi ekzistues nuk është në standarte optimale;
- Shërbimit i menaxhimit të mbetjeve nuk ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë;
- Venddepozitimi ekzistues nuk është në standarte optimale;
- Shkollat 9-vjeçare në zonat rurale janë në ndërtesa të degraduara;
- Shërbimi mjekësor ka nevojë për përmirësime në infrastrukturë dhe në pajisje.

Përmirësimi i Shërbimeve dhe Rehabilitimi i mjedisit:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve vendore;
- Uji i pishëm;
- Kanalizimet e ujërave të zeza;
- Ndalim i derdhjes së ujërave të ndotura në lumin Shkumbin;
- Mbrojtja e mjedisit dhe peizazhit;
- Menaxhim i mbetjeve.



SOCIAL-KULTURORE

- Mungojnë hapësirat për argëtim dhe ato rekreative;
- Niveli i papunësisë tek të rinjtë është i lartë;
- Probleme me barazinë gjinore;
- Papunësia tek gratë e lartë.

Shfytëzimi i objekteve që Bashkia ka në zotërim për zhvillimin e aktiviteteve sociale për grupmosha të ndryshme, duke filluar nga parashkollorët e deri tek grupmosha e tretë:

- Mbështetja e të rinjve;
- Ngritja e strukturave në mbështetjen e grave;
- Aktivitetet Social-Kulturore në zonë.



INFRASTRUKTURA

- Kemi vënde të përcaktuara për autobusë e mikrobusë por nuk janë brenda normave dhe nuk ofrojnë orare të caktuara të nisjes e mbërritjes në destinacion;
- Kemi probleme në sinjalistikën rrugore mungesën e semaforëve dhe vende vende trotuarët nuk janë brenda normave (janë të ngushtë) gjithashtu nuk kemi korsi të dedikuara për lëvizjen e biçikletave;
- Ka mungesa në sinjalistikën orientuese në rrugët kryesore e ato dytësore;
- Mungesa e një stacioni brenda normave;
- Ka mungesa në infrastrukturën hekurudhore dëmtime apo masa sigurie;
- Për shkak të ndërtimeve informale të viteve të fundit të cilët e kanë futur rrjetin hekurudhor në një zonë urbane duhen marrë masa për të rritur sigurinë me anë të semaforëve apo mbikalimeve etj.

Përmirësimi i Infrastrukturës Rrugore :

- Përmirësim i aksesit në zonë;
- Rregullim i infrastrukturës lokale;
- Rritja e sigurisë rrugore.

Asfaltimi i segmenteve kryesore rrugore me efekte në përmirësimin e ekonomisë, duke siguruar një akses më të mirë dhe më të shpejtë për banorët me qendrën e Peqinit dhe midis njësive të tjera, si dhe për të siguruar mundësi për tregëtimin e produkteve bujqësore që kultivohen në këto zona.

Gjithashtu kjo do të sigurojë dhe një akses më të mirë dhe më të shpejtë për vizitorët në të gjitha pikat më të rëndësishme turistike që ndodhen në zonë.



5.2 Vizioni për Bashkinë Peqin

“Bashkia Peqin, do të shfrytëzojë pozicionin e saj strategjik dhe potencialet natyrore, duke synuar promovimin e një identiteti të ri që përfaqëson në rajon një qendër të kulturës së zhvillimit bujqësor.

Pjesë e strategjisë së zhvillimit do të jetë përmirësimi i kushteve të jetesës nëpërmjet shfrytëzimit të potencialeve të çdo njësie administrative me anë të nxitjes dhe bashkëpunimit midis tyre.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të kushteve të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve sociale për të siguruar gjithë-përfshirjen e banorëve në të gjithë territorit e bashkisë”.




Figura 18: Harta e Vizionit për Bashkinë Peqin



PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL NË BASHKINË PEQIN

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
<i>Ngritja e Kapaciteteve vendore në menaxhimin, planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i>	1. Trajnimi i stafit në planifikimin dhe zhvillimin e territorit	Bashkia Peqin ka në strukturën e saj një staf prej 134 personash. Me ndryshimet e reformës-territoriale, Bashkisë i janë shtuar kompetencat si dhe tashmë duhet të menaxhojë një territorshumë më kompleks si nga pikëpamja hapësinore, ashtu dhe nga diversiteti i çështjevesociale, ekonomike e kulturore. Ngritja e kapaciteteve do të marrë në konsideratë çështjet: a. Planifikim dhe Menaxhim Territori; b. Trajtimi i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore). Rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe edhe për projekte të tjera të hartuaranë kuadër të Planit Operacional për Zhvillimin Vendor. Ky investim në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve do të garantojë një implementim të suksesshëm të projekteve të tjera si dhe do të ndihmojë në ngritjen e kapacitetit të bashkisë për të hartuar projektet dhe plane të tjera afatgjatë.	500,000- 700,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	50% Bashkia Donacione të tjera të tjera: MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE	a. Lidhje e marrëveshjeve me MZHU, AKPT, MMSR si dhe organizata të tjera, të cilat ofrojnë ngritje kapaciteteve në fushat e sipërpërmendura; b. Ndjekje e trajnimeve të specializuara të organizuara nga Qeveria, Organizata, Programe Ndërkombëtare etj.; c. Ndjekje të kurseve të specializuara; d. Vizita në Bashki të tjera për njohjen me praktika më të mira.	- Ngritja e kapaciteteve vendore në administratën publike. - Ngritja e kapaciteteve vendore në planifikimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore në menaxhimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore për menaxhimin e çështjeve sociale; - Ngritja e mekanizmit të referimit për dhunën në familje. - Ngritja e kapaciteteve do të aplikohet në të paktën 30 punonjës të qeverisjes vendore në sektorët kyç si planifikim i territorit, projekte strategjike, ndihma sociale, zhvillimi i programeve që integrojnë komponentin e barazisë gjinore, etj. Kjo gjë do të aplikohet jo vetëm për Njësinë Administrative Peqin, por edhe për stafin e Njërive të tjera Administrative. Ngritja e kapaciteteve të administratës vendore ndikon drejtpërdrejtë në ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj qytetërëve dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë gratë dhe grupe në nevojë. Gjithashtu, krijon një ambient të përgatitur për t'u përballur me sfidat territoriale të reformës administrative.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
	2. Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor	Bashkia Peqin nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikim-indhe zhvillimin e territorit”, të gjitha njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë planet e tyre vendore brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit. Duke marrë në konsideratë reformën territoriale dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015, atëherë dhe afati i hartimit të PPV është shtyrë. - Fillimisht është faza përgatitore ku duhen grumbulluar të gjithë materialet e nevojshme për hartimin e PPV, gjithashtu në këtë fazë duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit, sidhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit; - Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Në këtë fazë analizohen dhe evidentohen të gjitha aspektet e zhvillimit të territorit si ato urbanistike, mjedisore, zhvillimi ekonomik dhe social. Gjithashtu e rëndësishme është edhe ndërthurja e komponentëve të çështjeve gjinore; - Faza e tretë është	15,000,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	10-15% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, USAID, PLGP, OSCE, UNDP	- Nisma për hartimin e PPV (2-3 Javë); - Formimi i grupit të punës me përbërje të të dy gjinive (2-3 javë); - Formimi i Forumit për Bashkërendimin dhe Këshillimin, me pjesëmarrje të të dy gjinive (1-2 javë); - Hartimi i Analizës së thelluar të territorit (3-4 muaj); - Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit (2 muaj); - Hartimi i Planit të Përdorimit të Tokës dhe Rregullores së Planifikimit dhe Zhvillimit (3-4 muaj); - Dëgjesa Publike me pjesëmarrje të gjerë të të dy gjinive (të paktën 2 dëgjesa); - Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale dhe Vlerësimit Satrategjik Mjedisor (1 muaj); - Dërgim për miratim në KKT (1 muaj).	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e Bashkisë Peqin, fermerët, investitorët dhe vetë Bashkia. Rezultatet e pritshme: - Menaxhim më i mirë i territorit dhe kontroll mbi zhvillimin; - Mundësi për rritjen e investimeve dhe rritje ekonomike; - Ulja e numrit të popullsisë që largohet nga Bashkia; - Zhvillim i qëndrueshëm. Projekti bazohet në përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Projekti më pas do të garantojë bazën për zhvillimin e territorit të Bashkisë Peqin.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		Strategjia e Territorit dhe Vizioni Strategjik. Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritet kryesore. Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brendanë afati kohor të shkurtër. Faza e 4 lidhet me hartimin e Planit të Përdorimit të Tokës sidhe me rregulloret në zbatim të tij.	
	3. Ngritja e Zyrës me një ndalesë për “Zhvillimin e Territorit” (One Stop Shop)	Bazuar në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në VKM “Për Zhvillimin e Territorit”, në të cilën thuhet se “Njësitë e Qeverisjes vendore duhet të marrin masa për ngritjen e zyrave me një ndalesë për zhvillimin e territorit”. Deri më tani, Bashkia e Peqin nuk ka një strukturë të tillë dhe aplikimet për lejet e ndërtimit menaxhohen nga zyra e planifikimit të territorit. Projekti konsiston në hapjen e një zyre me një ndalesë për “zhvillimin e territorit”. Kjo zyrë do të kryejë shërbimet e nevo-	500,000 - 700,000 Lekë 4 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin AZHT	70-100% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, US- AID, PLGP, OSCE, UNDP	- Përcaktimin e vendit (zyrës), ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për Zhvillimin e Territorit; - Përcaktimi dhe plotësimi i stafit të përfshirë në këtë zyrë; - Trajnimi i stafit dhe njohja me dispozitat ligjore dhe proceduriale bazuar në Ligjin 107/2014 "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Plotësimi me bazën materiale si kompjutera, printera, internet, orendi zyre etj.	Projekti është i qëndrueshëm dhe në kombinim me dy projektet e mëparshme për ngritjen e kapaciteteve vendore dhe hartimin e PPV për Bashkinë, ofron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e territorit të Peqinit.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		jshme për kërkuesit e lejeve të ndërtimit. Disa nga shërbimet e zyrës lidhen me dhënien e informacionit mbi procedurat e lejeve të ndërtimit, koordinim institucional për thjeshtëzimin e procedurave të lejeve.	
<i>Diversifikimi i ekonomisë dhe zhvillimi ekonomik</i>	4. Pastrimi dhe Rikonstrukcioni i Kanaleve të Ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Peqin	Bujqësia është një ndër sektorët më të rëndësishëm ekonomik në Bashkinë e Peqinit. Veçanërisht në njësitë administrative Gjocaj, Shezë, Pajovë, Karinë dhe Përparim është baza kryesore e ekonomisë, ku mbi 70% e popullsisë janë të punësuar. Projekti konsiston në pastrimin dhe përmirësimin e kushteve (rikonstruksionin) të kanaleve të ujitjes dhe kullimit në bashkinë Peqin. Ai është i ndarë në disa faza dhe ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Për secilën fazë do të aplikohet tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.	55,000,000 Lekë 36 Muaj
	5. Ngritja e Qendrës së Grumbullimit dhe Tregut Rajonal	Spektori i Bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Peqin. Rreth 70% e punësimit është e bazuar në këtë sektor, çka reflekton rëndësinë që sektori ka në ekonominë vendore. Projekti parashikon ndërtimin e një	40,000,000 - 45,000,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin MBZHRAU	1-5% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU	- Përcaktimin e saktë të zonave në nevojë për ndërhyrje; - Përgatitjen e dokumentacionit për aplikim për fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU; Projekti mund të aplikohet edhe sipas fazave të mëposhtme: - Faza 1- Gjocaj; - Faza 2- Pajovë; - Faza 3- Kaninë; - Faza 4- Shezë; - Faza 5- Përparim.	70% e popullsisë është e punësuar në bujqësi, kështu që investimi pritet të sjellë një reduktim të kostove dhe vështirësive në prodhimtari. Projekti synon: - Mbrojtje nga përmbytjet; - Mbështetje të rritjes së produktivitetit; - Mbështetje të fermerëve; - Mbrojtje të Ujërave dhe Tokës Bujqësore; - Mbrojtja nga Përmbytjet.
Bashkia Peqin MBZHRAU	1% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU	- Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik); - Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU; - Ndërtimi i Qendrës së Grumbullimit; - Ndërtimi i ambjenteve të tregut;	70% e punësimit në Bashkinë Peqin është e bazuar në bujqësi. Si rrjedhojë masa përfitimeve pritet të prekë një gamë të gjerë të popullsisë. Disa nga përfitimet janë: - Krijimi i vendeve të reja të punës në kuadër të Qendrës së Grumbullimit dhe Tregut Rajonal (të paktën 30-40 vende pune,

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		qendre unike në llojin e saj. Kërkon të integrojë në një zonë të vetme Qendrën e Grumbullimit dhe Tregun Rajonal. Kombinimi i këtyre dy aspekteve, pra grumbullim dhe tregëtim rrit eficiencën dhe mundësitë e produkteve për të arritur në tregje më të gjera. Gjithashtu, në kuadër të Qendrës së Grumbullimit do të vendosen dhe aparaturat e nevojshme për kontrollin e cilësisë së produkteve.	
	6. Promovimi dhe Brandimi i Bashkisë Peqin	Në territorin e Bashkisë Peqin gjenden një numër i konsiderueshëm objetesh kulturore, historike (p.sh. rruga historike Egnatia). Gjithashtu, Bashkia Peqin ofron një peizazh fantastik, me një kombinim të peizazhit të ofruar nga Lumi Shkumbin, tokat bujqësore si dhe zonat kodrinore e malore. Produktet bujqësore dhe potenciali për të zhvilluar agro-turizmin në formë të ndryshme është shumë i madh, por mungon promovimi i këtyre potencialeve, të cilat do të shtojnë mundësitë për zhvillimin ekonomik si dhe zhvillimin rural. Projekti syn-	750,000 Lekë 6 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
		- Ngritja e zyrës për kontrollin e cilësisë dhe këshillimit të fermerëve; - Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike me anë të kompostimit; - Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj.	nga të cilat do të përfitojnë të dy gjinitë); - Mbështetja e fermerëve (trajnime, konsultime, kontroll sigurie të produkteve etj). - Siguri për produktet bujqësore; - Rritje e tregtimit të produkteve bujqësore; - Mbështetje ndaj fermerëve; - Ngritje kapaciteti (duke operuar edhe si qendër trajnimi).
Bashkia Peqin	50% Bashkia Donacione të tjera të mundshme	- Krijimi i një logoje për Brandimin e Bashkisë Peqin; - Krijimi i databazës për potencialet natyrore, kulturore, historike e peizazhistike; - Krijimi i një liste aktiviteteve promovuese si panaire, festivale, konferenca, seminare; - Krijimi i faqes elektronike që ofron informacionin për promovimin e Bashkisë; - Hartimin e broshurave e materialeve të tjera promovuese.	Përfitues janë të gjithë banorët e Bashkisë. Projekti synon: - Rritjen e numrit të vizitorëve; - Rritjen e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e investitorëve; - Promovimin e Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar - Krijimin e një brand (marke) për Bashkinë Peqin; - Promovimin e produkteve bujqësore dhe potencialeve për agro-turizëm; - Promovimin e potencialeve natyrore; - Krijimin e një kalendari aktiviteteve me fokus promovimin e potencialeve të Peqinit.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		on rritjen e vizibilitetit të Bashkisë Peqin dhe promovimit të potencialeve. Projekti përbëhet nga disa hallka të lidhura me njëra tjetrën, si krijimi i një “marke” të dedikuar për Peqinin. Krjimi i një faqeje interneti për komunikimin me publikun, vizitorët dhe promovimin e potencialeve e aktiviteteve që zhvillohen në Peqin.	
Infrastruktura rrugore	7. Ngritja e vendqëndrimit të mjeteve të transportit të pasagjerëve (autobuza, minibus, stacion treni)	Për momentin vendqëndrimi i mjeteve të transportit ndërrurban për pasagjerë është pozicionuar në qendër të Peqinit, pranë Kalasë. Ky vendqëndrim nuk është i përshtatshëm dhe shkakton trafik të panevojshëm në orët kryesore të lëvizjes. Gjithashtu nuk është i lidhur me forma të tjera të transportit si tren, pedalim, etj. Për të zgjidhur këtë problematikë, projekti synon krijimin e një vendqëndrimi të ri përmjetet e transportit të pozicionuar pranë stacionit të trenit. Projekti përbëhet nga: - Vendet e qëndrimit dhe parkimit të mjeteve; - Zyrat e shërbimit ndaj qytetarit, si biletari dhe informacion;	18,000,000 Lekë 16 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	0% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore	- Hartimin e Projektit për Zbatim; - Aplikimin për fonde; - Përgatitjen e zonës dhe implementimin e projektit.	Përfitues janë banorët e Bashkisë Peqin, përfshirë gratë, të cilat rezultojnë se janë përdoruese të shpeshta të transportit publik. Projekti synon: - Përmirësimin e ofrimit të shërbimit të transportit ndërrurban; - Zbutjen e trafikut dhe konfuzionit në lidhje me transportin; - Ndërlidhje më të mirë rajonale; - Sistem i rregullt transporti ndërrurban; - Orare strikte dhe kushte të përshtatshme shërbimi; - Rritje të sigurisë së transportit publik; - Shmangien e trafikut të rëndëruar dhe rrëmujës në brendësi të qytetit, apo përgjatë rrugëve.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		- Vend pritjeje; - Rikonstruksion i stacionit të trenit; - Rigjenerim i zonës.	
	8. Përmirësimi i Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore	Bashkia Peqin përshkohet në mes nga dy akse të forta si rruga nacionale Rogozhinë-Elbasandhe Hekurudha. Të dyja këto akse shpesh bëhen burim aksidentesh si rrjedhojë e mungesës së sinjalistikës së përshatshme dhe urave të kalimit për këmbësorë. Për këtë arsye, projekti synon përmirësimin e sinjalistikës me qëllim rritjen e sigurisë në rrugë për këmbësorë dhe automjete. Projekti parashikon vendosjen e sinjalistikës rrugore në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale. Gjithashtu vendosjen e sinjalistikës së përshatshme në kalimet në nivel midis rrugëve dhe hekurudhës. Vendosjen e dy urave të kalimit për këmbësorë përgjatë aksit kombëtar Rogozhinë-Elbasan. Në fund mbyllet e kalimeve informale ose vendosjen e sinjalistikës për rritjen e sigurisë përgjatë hekurudhës.	12,000,000 Lekë 16 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	15% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.	- Vendosija e sinjalistikës në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan; - Vendosijen e sinjalistikës dhe mjeteve mbrojtëse në kalimet në nivel midis hekurudhës dhe rrugëve; - Përcaktimin e vendit për pozicionimin e dy urave të kalimit për këmbësorë, përgjatë rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan.	Përfitues të këtij projekt janë të gjithë banorët e Peqinit si dhe të gjithë udhëtarët në aksin Rrogozhinë-Elbasan. Rezultati kryesor i projektit është reduktimi i aksidenteve rrugore dhe rritja e sigurië rrugore. Ai konsideron edhe: - Uljen e numrit të aksidenteve; - Rritjen e sigurië për këmbësorë përgjatë aksit Rrogozhinë-Elbasan; - Rritjen e sigurië në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan; - Rritjen e sigurië në kryqëzimet midis hekurudhës dhe rrugëve.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
	9. Përmirësimi i ndriçimit rrugor në qytetin e Peqinit	Qyteti i Peqinit (Census 2011) ka një popullsi prej 6,500 banorësh. Ndriçimi rrugor ekziston vetëm përgjatë bulevardit “Mustafa Gjinishi”, ndërkohë në rrugët e tjera është i mangët ose i dëmtuar. Kjo gjë shkakton një problematikë të theksuar në lidhje me sigurinë në rrugë, si edhe në lidhje me kryerjen e veprave të ndryshme penale, përfshirë veprat penale për shkak të seksit. Projekti konsiston në pajisjen me ndriçim rrugor të disa akseve të qytetit të Peqinit. Me anë të këtij projekti kërkohet që të rinovohet edhe sistemi ekzistues, duke aplikuar ndriçues të cilët përdorin energjinë në mënyrë efçente (llampa të posaçme panele diellore etj.). Në këtë kontekst do të ri-modelohet sistemi i ndriçimit të rrugëve: - Mustafa Gjinishi; - Ismail Bej Kadiu; - Abdurrahim Pasha; - Sulejman Pasha; - Ramazan Cani;	15,000,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	10% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.	- Përcaktimin e akteve kryesore dhe sasisë ekzakte të ndriçuesve; - Përcaktimin e saktë të teknologjisë që do të përdoret për ndriçuesit; - Aplikimin për fonde; - Implementimin e projektit.	Disa nga rezultatet e pritshme përfshijnë që nga projekti të përfitojnë rreth 6,500 banorë. Përfitimi do të jetë jo vetëm për banorët, por edhe për bizneset që operojnë në këtë zonë pasi ndryshon dhe imazhi i qendrës së Peqinit. Pritet gjithashtu zvogëlim i kostove të energjisë elektrike për ndriçim rrugor, duke qënë se projekti bazohet në ndriçues, të cilët prodhojnë vetë një pjesë të madhe të energjisë. Duke rritur sigurinë rrugore dhe reduktuar veprat penale për shkak të seksit , pritet të ketë një integritet më të madh të të rinjve, sidomos të gjinisë femërore në aktivitetet dhe jetën sociale të qytetit, si edhe parandalim të akteve të dhunës të kryera ndaj tyre.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve	10. Përmirësimi i cilësisë së Shkollave 9-vjeçare	Shkollat 9-vjeçare në Bashkinë Peqin përgjithësisht kanë nevojë për rikonstruksion, pasi janë në gjendje jo të mirë. Ndërtesat janë të amortizuara dhe nuk ofrojnë ambiente të përshtatshëm për mësimdhënie. Strukturat janë të vjetëruara dhe kanë mangësi në izolime termoizolim, duke rritur mjaft kostot e përdorimit të mjeteve alternative për të siguruar kushtet e përshtatshme gjatë periudhës së pikut, në verë dhe dimër. Projekti konsiston në rikonstruksionin dhe përmirësimin e godinave të dy shkollave 9-vjeçare, një në qytetin e Peqinit dhe tjetra në Njësinë Administrative Gjocaj; dhe ndërtimin e një strukture të re për shkollë 9-vjeçare "Demir Godeli" në qytetin e Peqinit, godina aktuale e së cilës është në kushte kritike.	29,743,867 Lekë 36 muaj
	11. Rikonstruksioni i 3 Ambulancave në Njësitë Administrative Pajovë dhe Gjocaj	Situata e ndërtesave të Ambulancave në Bashkinë Peqin, dhe sidomos në zonat rurale, është mjaft e dobët. Shumë prej tyre janë të amortizuara dhe në nevojë për rikonstruksion. Gjithashtu, edhe përsa i përket pajisjeve nga vizitat në	18,000,000 Lekë 35 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	0% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar	• Faza 1: Rikonstruksioni i dy shkollave - Hartimi i projektit të detajuar; - Rikonstruksion i shkollave dhe konvertim në qendra për komunitetin; • Faza 2: Ndërtimi i shkollës së re - Gjetja e fondeve të financimit; - Shembja e shkollës së vjetër dhe bërja gati e terrenit për punime; - Ndërtimi i strukturës së re.	- Kushte më të mira dhe performancë më e mirë nga nxënësit dhe mësuesit e shkollave 9-vjeçare, kushtet e të cilave do të përmirësohen; - Gratë si përfituese të shërbimeve të qendrës komunitare; - Rritje e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën 9-vjeçare. - Përmirësimi i cilësisë së strukturave dhe kushteve të shkollave 9-vjeçare; - Shkollat si qendra komunitare; - Nxitja e arsimit tek fëmijët e këtyre zonave.
Bashkia Peqin	0% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për shëndetësinë	- Faza 1: Ambulanca në Njësinë Administrative Pajovë; - Faza 2: Ambulanca në fshatin Gjocaj, në Njësinë Administrative Gjocaj; - Faza 3: Ambulanca në fshatin Kurtaj, në Njësinë Administrative Gjocaj.	Përfitues të projektit janë: - Të gjithë banorët e këtyre zonave; - Gratë dhe nënat e reja; - Të moshuarit. Projekti synon: - Përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor; - Plotësimin me pajisje për kontrollin shëndetësor;

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		terren, vërehet që ka mangësi. Projekti konsiston në përmirësimin e godinave të 3 ambulancave: 1 në Njësinë Administrative-Pajovë, dhe 2 të tjera në Njësinë Administrative Gjocaj, përkatësisht në fshatrat Gjocaj dhe Kurtaj.	
Mirëqënia sociale dhe ekonomike	12. Ngritja e Zyrës së Punës në Peqin	Bashkia Peqin ka një shifër të lartë papunësie, veçanërisht tek të rinjtë dhe tek gratë. Jo vjen deri diku si rrjedhojë e mbështetjes së ekonomisë vendase, kryesisht në sektorin bujqësor ndërkohë që sektorët e tjerë të shërbimeve dhe industrisë janë shumë të vegjël për të gjeneruar punësim për të gjithë. Për këtë arsye, ky projekt konsiston në hapjen e zyrës së punës në Bashkinë Peqin, e cila do të kontribuojë veçanërisht edhe në diversifikimin e vendeve të punës dhe rritjen e mundësive për punësim tek të rinjtë dhe gratë.	700,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
			- Përmirësim i kushteve të ndërtesave të spitalit dhe qendrave shëndetësore.
Bashkia Peqin	100% Bashkia	- Përcaktimi në vendit të zyrës; - Rregullimin e ambjenteve të punës dhe plotësimin me material; - Gjetjen dhe trajnimin e stafit; - Krijimin e lidhjeve strategjike me Bizneset lokale; - Organizimin e eventeve trajnuese dhe “networking” midis punëdhënës-punëmarrës; - Organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave lokale.	- 10,000 përfitues të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë, të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere për mbi 1,000 nxënës të shkollave të mesme të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere dhe trajnim për të rinj të papunë, të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim dhe trajnim për gratë e papuna; - Mundësi punësimi për të rinjtë, të rejtat dhe gratë e papuna si edhe qytetarët e tjerë të trajnuar. Uljen e nr. të papunësisë tek të rinjtë; - Uljen e nr. të papunësisë tek gratë; - Ndërlidhjen midis punëdhënësve dhe punëmarrësve; - Rritjen e aftësive/trajnimin e qytetarëve në bazë të kërkesave të tregut; - Ofrimin e kurseve profesionale për grupe në nevojë si të rinj, të reja dhe gra të papuna.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
	13. Rikonstruktimi dhe fuqizimi i Qendrës Multifunktionale Kulturore Peqin	Bashkia Peqin me reformën e re territoriale ka një popullsi prej rreth 38,000 banorësh, duke pasur një rritje të konsiderueshme të grupmoshave të reja dhe grupeve të ndryshmetë interesit. Momentalisht në Bashki Qendra Kulturore “Ferdinand Deda” është pika, kuzhvillohen aktivitetet e ndryshme që prekin të rinjtë, por në anën tjetër ka grupe, interesat dhe nevojat e të cilave kjo qendër nuk i mbulon me profilin që ka. Ky projekt parashikon të jetë një katalizator i jetës sociale në Peqin për shkak të karakteritsocial dhe edukues. I përbërë nga dy nënprojekte synon të ketë një impakt të gjërë dhe gjithëpërfshirës, duke plotësuar nevojat aktuale të qytetit. Aktorët e përfshirë janë Bashkia Peqin, minisitritë përkatëse për aktivitet kulturore dhe kurset profesionale, OJF-të, organizatat dhe banorët.	23,000,000 Lekë 16 muaj
	14. Rigjenerimi i fasadës së Kalasë dhe Banjove Publike	Në qytetin e Peqinit ndodhet dhe Kalaja e Peqinit. Një objekt historik, i cili si pasojë emungesës së fondeve është	30,000,000 Lekë 16 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	10% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parau-niversitar dhe uni-versitar	- Përgatitjen e projektit të deta-juar të qendrës, - Aplikimi për fonde dhe imple-mentimi i projektit; - Ngritja e bordit drejtues dhe strukturave menaxhuese; - Promovimi i Qendrës Multi-funksionale; - Ndërlidhja me OJQ dhe Pro-grame të ndryshme; - Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.	- Përmirësimi i jetës sociale në Peqin; - Aktivizimi i të rinjve në aktivi-tete jashtë-shkollore; - Trajnimi i të rinjve; - Ngritja e kapaciteteve për punësim tek gratë; - Mbështetja dhe integrimi i grave në shoqëri. Gjithashtu, pas rimodelimit të Qendrës Kulturore “Ferdinand Deda” në një Qendër Multifunk-sionale, Bashkia do të formojë bordin drejtues dhe strukturat menaxhuese, të cilat do të ku-jdesen për mirëmbajtjen. Një pjesë e fondeve do të gjenero-hen nga Bashkia, ndërkohë që pritet që Qendra Multifunksio-nale të aftësohet gjithashtu për të gjeneruar të ardhurat e saja, duke aplikuar me anë të projek-teve në programe dhe donatorë të ndryshëm.
Bashkia Peqin	10% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR Granti	- Pastrimin e zonës nga mbetjet; - Gjetjen e vendit për zhvendos-jen e banjove publike; - Pastrimin dhe rigjenerimin e mureve të kalasë;	Përfitues direkt të këtij projek-ti do të jenë banorët e qytetit të Peqinit (rreth 6,500 banorë). Ndërkohë në mënyrë indirekte do të jenë të gjithë banorët e

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		lënë pas dore, duke mos u shfrytëzuar si një potencial ekonomik. Përtej mungesës së investimeve në Kala, pranë saj gjenden banjot publike, të cilat janë në kushte shumë të këqia dhe përbëjnë rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive. Projekti ka si synim rigjenerimin e murit të kalasë së Peqinit dhe të banjove publike. Fillimisht do të ndryshohet vendqëndrimi i mjeteve të transportit, duke e çliaruar këtë hapësirë për qytetarët. Më pas do të pastrohen dhe rikonstruktohen banjot publike në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më i pastër për qytetarët.	
	15. Rikonceptimi i Pyllit të Pishave dhe kthimi i tij në Park Rekreativ	Pylli i Pishave është një ndër hapësirat kryesore rekreative në qytetin e Peqinit. Gjithësesi aty nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi apo komoditeti për ta konsideruar atë si një hapësirë kualitative rekreative. Duke qënë se është e vetmja zonë e gjelbër, ka një frekuentim të lartë	15,000, 000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
	konkurrues për kulturën dhe Granti konkurrues për infrastrukturën vendore konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar	- Pajisjen e Kalasë me ndriçim dhe tabela përkatëse të sinjalistikës dhe informimit; - Shqyrtimin e mundësive për restaurimin e plotë të Kalasë në të ardhme, në një faze të mëvonshme.	Bashkisë. Rezultate të tjera të pritshme janë edhe: - Rritja e numrit të vizitorëve; - Stimulimi për gjetjen e fondëve për restaurimin e plotë të Kalasë Peqin; - Përmirësimi i imazhit të qytetit; - Mbrojtja e monumenteve historike; - Krijimi i hapësirave publike për qytetarët; - Krijimi i ambjenteve tërheqëse për vizitorët; - Pastrimi i banjove publike.
Bashkia Peqin	10% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti Konkurrues për Infrastrukturën Vendore.	- Hartimin e projektit; - Bërjen gati të zonës për ndërrhyrje; - Mbjellja e 50 pishave të reja; - Pajisja me ndriçim e zonës - Krijimi i zonave sportive; - Krijimi i zonës së lojrave për fëmijë; - Pajisja me 30 stola; - Pajisja me 30 kosha për hedhjen e mbetjeve.	Përfitues direkt të projektit do të jenë 6,500 banorët e qytetit të Peqinit. Përfitues të tjerë do të jenë banorët e Njësive Administrative të tjera. Projekti synon: - Ngritjen e dy fushave të futbollit (mini futbollit); - Krijimin e një fushe tenisi; - Krijimin e një fushe basketbolli; - Krijimin e një fushe voleybolli; - Krijimin e Palestrës së Hapur në natyrë; - Vendosje e 30 stolave;

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		sidomos gjatë fundjavave. Për këtë arsye me anë të këtij projekti synohet që të përforcohet aspekti i Pyllit të Pishave si një hapësirë rekreative në qytetin e Peqinit. Projekti do të konsistojë në një rikonceptim të pyllit nga pikëpamja e “peizazhit” si dhe përmirësim të shërbimeve të ofruara në të. Do të shtohen terrene sportive për sporte si futboll, tenis, basketboll, voleyboll. Gjithashtu dotë krijohet një palestër e hapur, e shoqëruar me hapësira për vrapim.	
Mjedisi	16. Hapja e vend-depozitimit të ri të mbetjeve dhe mbyllja e atij ekzistues.	Sheshi aktual i depozitimit të mbetjeve urbane ndodhet në dalje të qytetit, e vendosur pranë rrugës nacionale. Bazuar në të dhënat e marra nga Ministria e Zhvillimit Urban ky vend-depozitim është jashtë standarteve. Ai është jo sanitar dhe i dëmshëm për mjedisin. Projekti parashikon në radhë të parë studimin e detajuar të problemeve të vend-depozitimitekzistues. Marrjen e masave për mbylljen e tij dhe më pas konvertimin e kësaj hapësirë të ndotur në një	45,000,000 Lekë 22 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
			- Vendosje e 30 koshave për mbeturina; - Mbjellja e 50 pishave të reja; - Pajisja me ndriçim e të gjithë zonës.
Bashkia Peqin	0% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.	- Përgatitjen e projektit teknik të detajuar; - Hapjen e vend-depozitimit të ri; - Mbylljen e vend-depozitimit ekzistues; - Gjelbërimin e zonës së vend-depozitimit ekzistues.	Numri i përfituesve do të jetë i barabartë me të gjithë banorët e Bashkisë Peqin. Në përfitimet e projektit përmendim: - Uljen e ndotjes mjedisore; - Reduktimin e rreziqeve për sëmundje, si rrjedhojë e kushteve jo-sanitare të vend-depozitimit ekzistues; - Mbylljen e vend-depozitimit ekzistues; - Hapjen e një vend-depozitimi të ri me kushte dhe standarte të larta.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		zonë të gjelbër. Në gjelbërimin e zonës do të përdoren bimësi, të cilat dotë bëjnë rigjenerimin dhe rehabilitimin natyror të zonës. Hapi i dytë i këtij projekti përfshin hapjen e një vend-depozitimi të ri në një parcelë prej 7,000m² me nr. pasurie 108/1 dhe ZK3055, në kushte dhe standarte sipas legjislacionit në fuqi.	
	17. Projekt Pilot, Kompostimi në Bazë Ferme	Promovimi i kompostimit në bazë ferme është një përpjekje për të ulur sasinë e mbetjeve. Gjithashtu ky projekt do të përdoret më pas si një shembull dhe një model i mirë për t'u shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë. Projekti do të fokusohet kryesisht në promovimin e kompostimit kryesisht në zonat rurale, duke qenë se për shkak edhe të karakteristikave ato janë më të përshtatshme për ta zhvilluar këtë lloj aktiviteti. Kompostimi në familje konsiston në trajtimin vetëm të mbetjeve organike të gjeneruara nga ajo. Kompostimi është një proces i thjeshtë dhe	3,000,000 Lekë 6 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Peqin	10% Bashkia Donacione të tjera të mundshme: - FZHR- Granti konkurues për infrastrukturën rrugore - OJQ - Programe ndër-kombëtare në fushën e mjedisit; - Etj.	- Përzgjedhja e fermerëve; - Trajnimi i tyre; - Shpërndarja e koshave; - Diseminimi i njohurive tek fermerët e tjerë.	Fillimisht nga projekti do të përfitojnë 50 fermerë. Projekti synon: - Ndërgjegjësim në lidhje me mbetjet organike; - Mundësi të reja nga kompostimi. - Ulja e rrymës së mbetjeve që depozitohen në kosha; - Trajtimi i mbetjeve organike dhe kthimi i tyre në pleh; - Rifutja e mbetjeve organike në ciklin e aktivitetit bujqësor; - Trajnimi i sa më shumë familjeve, për ta kthyer kompostimin në një praktikë të rregullt, në të gjithë Bashkinë.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		efikas për të ulur rrymën e mbetjeveqë depozitohet në kosha, e në të njëjtën kohë i kthen mbetjet organike në pleh, i cili mund të përdoret më vonë në bujqësi. Për kryerjen e kompostimit nevojitet një kosh mepërmasa 1m3, i cili mund të pozicionohet në pjesën e mbrapme të shtëpive.	



PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIM DHE PLANIFIKIMIN E TERRITORIT



Bashkia Peqin nuk zotëron ndonjë plan të zhvillimit të territorit, dhe njëkohësisht nuk ka filluar proceset e hartimit të planit të përgjithshëm vendor, apo të strategjisë së zhvillimit të territorit. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Bashkitë, brenda një afati kohor prej dy vjetësh nga miratimi i ligjit duhet të hartojnë planet e përgjithshme vendore.

Në kontekstin e planifikimit të territorit, plani operacional për zhvillimin lokal nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor, por ndihmon në procesin e hartimit të tij. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i kujdesshëm që të shfrytëzojë procesin e hartimit të Planit Operacional për Zhvillimin Lokal edhe si pjesë e procesit të vizionimit.

Bashkia, tashmë ka të identifikuar disa prej problematikave më kryesore si dhe disa prioritetet zhvillimi. Edhe pse vizioni është ende në fillesat e hartimit të tij, përbën një bazë të mirë për të filluar hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit. Për të arritur në formulimin e strategjisë është e nevojshme që bazuar në prioritetet e përcaktuara në këtë dokument të elaborohen më tej politikat përkatëse sektoriale në mbështetje të vizionit dhe qëllimeve të zhvillimit.

Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, shërben si një hap fillestar në proceset e planifikimit por që në asnjë mënyrë nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor. Në të identifikohen problematikat kryesore dhe parashtrihen disa prioritetet zhvillimi të cilat më pas duhet të mbështeten me politika të qarta lokale (strategjia e zhvillimit) si dhe të përkthehen në përdorime të përshtatshme të tokës (plani i përdorimit të tokës) të shoqëruara me rregullat përkatëse të zhvillimit (rregulloret e planit të përgjithshëm vendor).

Hartimi i planit të përgjithshëm vendor kalon në disa faza. Fillimisht duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit si dhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit. Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Faza e tretë është strategjia e territorit dhe vizioni strategjik.

Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritetet kryesore. Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brenda një afati kohor të shkurtër. Faza e 3 lidhet me hartimin e Planit të Përdorim-

it të Tokës si dhe me rregulloret në zbatim të tij. Në fund, hartohen planet e investimeve si dhe vlerësimi strategjik mjedisor. Gjatë gjithë kohës së hartimit të planit të përgjithshëm vendor, Bashkia duhet të sigurojë përfshirjen e publikut. Në fund plani duhet të shoqërohet me procesin paralel të hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.





ANEKSI 1

(PROJEKT - FISHAT)

NGRITJA E KAPACITETEVE VENDORE NË MENAXHIMIN, PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT

PROJEKT 1	
• Titulli i projektit	Trajnimi i Stafit Lokal në Planifikim Terriori dhe Aspekte Sociale
• Tipi i Projektit	Shërbime Publike/ Kapacitete Vendore
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin (duke integruar stafin e Njësive Administrative)
• Buxheti total i projektit	500,000- 700,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 50% Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE
• Përshkrimi i projektit	Bashkia Peqin ka në strukturën e saj një staf prej 134 personash. Me ndryshimet e reformës territoriale, Bashkisë i janë shtuar kompetencat si dhe tashmë duhet të menaxhojë një terrior shumë më kompleks si nga pikëpamja hapësinore, ashtu dhe nga diversiteti i çështjeve sociale, ekonomike e kulturore. Gjithashtu, koordinimi i Njësive Administrative është një sfidë më vete, me të cilën përballlet Bashkia. Në mënyrë që të garantohej një zhvillim sa më i qëndrueshëm i Bashkisë si dhe të ofrohet një shërbim sa më cilësor ndaj qytetarit është tejet e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e punonjësve të qeverisë vendore. Në këtë aspekt janë identifikuar dy fusha si më prioritaret: a. Planifikim dhe Menaxhim Terriori; b. Trajtimi i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore). Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të terriorit, trajnimet mund të konsistojnë në: - Hartim politikash zhvillimi; - Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit; - Përdorim i GIS dhe Regjistrat të Terriorit; - Ngritja e databazës së të dhënave për Bashkinë e re të Peqinit, menaxhimi dhe përditësimi i saj i vazhdueshëm; - Menaxhim Projektesh; - Përgatitje dhe zhvillim projektesh që synojnë të integrojnë interesat e të dy gjinive në të gjitha fushat; - Rregulla të përdorimit të tokës; Ndërkohë përsa i përket çështjeve sociale trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve mund të konsistojnë në: - Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje; - Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara; - Trajnime për këshillimin e të rinjve; - Trajnime për strehimin social; - Trajnime për integrimin e grave dhe të rinjve në shoqëri; - Roli i specialistit të barazisë gjinore dhe koordinatorit vendor të dhunës në familje në Bashki;

	- Nga puna për mbledhjen e të dhënave ka rezultuar se Bashkia Peqin nuk ofron shërbime sociale, përveç ndihmës ekonomike. Në këto kushte një nga temat me interes mund të jetë ofrimi i shërbimeve sociale dhe buxheti i shërbimeve sociale në nivel vendor. Këto çështje marrin një rëndësi të veçantë në kushtet e mungesës në zonë të organizatave të ndryshme jofitimprurëse që punojnë me çështjet e barazisë gjinore, të drejtave të grave, ofrimit të shërbimeve sociale, etj.
• Qëllimi dhe objektivat	- Ngritja e kapaciteteve vendore në administratën publike. - Ngritja e kapaciteteve vendore në planifikimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore në menaxhimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore për menaxhimin e çështjeve sociale; - Ngritja e mekanizmit të referimit për dhunën në familje.
• Rezultatet e pritshme	Ngritja e kapaciteteve do të aplikohet në të paktën 30 punonjës të qeverisjes vendore në sektorët kyç si planifikim i territorit, projekte strategjike, ndihma sociale, zhvillimi i programeve që integrojnë komponentin e barazisë gjinore, etj. Kjo gjë do të aplikohet jo vetëm për Njësinë Administrative Peqin por edhe për stafin e Njërive të tjera Administrative. Ngritja e kapaciteteve të administratës vendore ndikon drejtpërdrejtë në ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë gratë dhe grupe në nevojë. Gjithashtu, krijon një ambient të përgatitur për t'u përballur me sfidat territoriale të reformës administrative.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe edhe për projekte të tjera të hartuara në kuadër të Planit Operacional për Zhvillimin Vendor. Ky investim në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve do të garantojë një implementim të suksesshëm të projekteve të tjera si dhe do të ndihmojë në ngritjen e kapacitetit të bashkisë për të hartuar projekte dhe plane të tjera afatgjatë.
• Aktivitetet e projektit	Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe në të parashikohen: - Lidhje e marrëveshjeve me MZHU, AKPT, MMSR si dhe organizata të tjera, të cilat ofrojnë ngritje kapaciteti në fushat e sipërpërmendura; - Ndjekje e trajnimeve të specializuara të organizuara nga Qeveria, Organizata, Programe Ndërkombëtare etj.; - Ndjekje të kurseve të specializuara; - Vizita në Bashki të tjera për njohjen me praktika më të mira;
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim.	Projekti është në nivel koncept ideje. Duhet dakordësuar me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Minis-trinë e Mirëqënies Sociale, Universitete, Programe Ndërkombëtare, OJQ/F për organizimin e trajnimeve. Gjithashtu duhen krijuar kontakte (ose binjakëzime) me Bashki të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për njohjen me praktika të mira.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 2	
• Titulli i projektit	Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor
• Tipi i Projektit	Planifikim Territori
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin
• Buxheti total i projektit	15,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10-15 % Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE
• Përshkrimi i projektit	Bashkia Peqin nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të gjitha njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë planet e tyre vendore brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit. Duke marrë në konsideratë reformën territoriale dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015, atëherë dhe afati i hartimit të PPV është shtyrë. Në këtë kontekst, Bashkia Peqin, bazuar në dispozitat ligjore duhet të hartojë PPV brenda vitit 2017. Gjithashtu, PPV është i nevojshëm për të mundësuar që zhvillimi të jetë sa më i qëndrueshëm. Bashkitë mund të japin leje ndërtimi vetëm në sajë të PPV. Në këtë kontekst, hartimi i PPV është tejet i nevojshëm për mirë menaxhimin dhe zhvillimin e territorit të Bashkisë. Në fund, PPV është i nevojshëm për koordinimin e politikave të ndryshme sektoriale dhe drejtimin e punës dhe projekteve të Bashkisë. Projekti përbëhet nga disa faza. Fillimisht është faza përgatitore ku duhen grumbulluar të gjithë materialet e nevojshme për hartimin e PPV, gjithashtu në këtë fazë duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit, si dhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit. Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Në këtë fazë analizohen dhe evidentohen të gjitha aspektet e zhvillimit të territorit si ato urbanistike, mjedisore, zhvillimi ekonomik dhe social. Gjithashtu e rëndësishme është edhe ndërthurja e komponentëve të çështjeve gjinore. Faza e tretë është Strategjia e Territorit dhe Vizioni Strategjik. Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritet kryesore. Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brenda një afati kohor të shkurtër. Faza e 4 lidhet me hartimin e Planit të Përdorimit të Tokës si dhe me rregulloret në zbatim të tij. Në fund, hartohen Planet e Investimeve Kapitale si dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor. Gjatë gjithë kohës së hartimit të PPV, Bashkia duhet të sigurojë përfshirjen aktive të publikut.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i punës konsiston në një numër aktivitete/studimesh që do të çojnë drejt produktit final të dokumentit të Planifikimit të Përgjithshëm Vendor dhe komponentëve të tij, sipas përcaktimeve të Ligjit dhe rregulloreve në zbatim të tij.

• Rezultatet e pritshme	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e Bashkisë Peqin, fermerët, investitorët dhe vetë Bashkia. Rezultatet e pritshme: - Menaxhim më i mirë i territorit dhe kontroll mbi zhvillimin; - Mundësi për rritjen e investimeve dhe rritje ekonomike; - Ulja e numrit të popullsisë që largohet nga Bashkia; - Zhvillim i qëndrueshëm.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti bazohet në përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Projekti më pas do të garantojë bazën për zhvillimin e territorit të Bashkisë Peqin.
• Aktivitetet e projektit	Projekti për Hartimin e PPV për Bashkinë Peqin parashikohet të zgjasë për një periudhë 12 Mujore. Në të parashikohen aktivitetet e mëposhtme: - Nisma për hartimin e PPV (2-3 Javë); - Formimi i grupit të punës, me përbërje të të dy gjinive (2-3 javë); - Formimi i Forumit për Bashkërendimin dhe Këshillimin me përbërje të të dy gjinive (1-2 javë); - Hartimi i Analizës së thelluar të territorit (3-4 muaj); - Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit (2 muaj); - Hartimi i Planit të Përdorimit të Tokës dhe Rregullores së Planifikimit dhe Zhvillimit (3-4 muaj); - Dëgjesa Publike me pjesëmarrje të gjerë të të dy gjinive (të paktën 2 dëgjesa); - Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale dhe Vlerësimit Satrategjik Mjedisor (1 muaj); - Dërgim për miratim në KKT (1 muaj).
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Hartimi i PPV shoqërohet me Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Kjo gjë garanton që impakti i politikave territoriale të jetë sa më i vogël në mjedis, si dhe garanton masat, të cilat duhen marrë në mënyrë që të minimizohen problematikat si dhe të përmirësohet cilësia e mjedisit. Një komponent i rëndësishëm i VSM ka të bëjë edhe me ndryshimet klimatike dhe me marrjen e masave, në mënyrë që Bashkia të jetë sa më e përgatitur në këtë aspekt.
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim.	Plani Operacional për Zhvillimin Lokal ofron një bazë të mirë për fillimin e punës për hartimin e PPV. Në të janë identifikuar disa nga problematikat kryesore me të cilat përballlet Bashkia, si dhe janë përcaktuar prioritetet për zhvillim. Ky plan përbën bazën për fillimin e punës për hartimin e PPV dhe drejtimet kryesore mbi të cilat duhet të bazohet plani.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Hartimi i PPV bazohet në: - Parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Planin e Përgjithshëm Kombëtar (draft).

PROJEKT 3	
• Titulli i projektit	Ngritja e Zyrës me një ndalesë për “Zhvillimin e Territorit” (One Stop Shop)
• Tipi i Projektit	Shërbime Publike
• Vendndodhja e projektit	Peqin (Qytet)
• Buxheti total i projektit	500,000 - 700,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 70-100%
• Përshkrimi i projektit	Bazuar në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në VKM “Për Zhvillimin e Territorit”, në të cilën thuhet se “Njësitë e Qeverisjes vendore duhet të marrin masa për ngritjen e zyrave me një ndalesë për zhvillimin e territorit”. Deri më tani, Bashkia Peqin nuk ka një strukturë të tillë dhe aplikimet për lejet e ndërtimit menaxhohen nga zyra e planifikimit të territorit. Projekti konsiston në hapjen e një zyre me një ndalesë për “zhvillimin e territorit”. Kjo zyrë do të kryejë shërbimet e nevojshme për kërkuesit e lejeve të ndërtimit. Disa nga shërbimet e zyrës lidhen me dhënien e informacionit mbi procedurat e lejeve të ndërtimit, koordinim institucional për thjeshtëzimin e procedurave të lejeve. Gjithashtu, në një fazë të dytë, pasi zyra të ketë fituar eksperiencë mund të kalohet në ofrimin e shërbimit për Lejet Elektronike. Ky është një projekt, i cili po aplikohet fillimisht nga MZHU në nivel qendror dhe që më pas mund të aplikohet në nivel vendor.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i punës konsiston në reduktimin e burokracive procedurale dhe thjeshtëzimin e procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit. - Ngritja e zyrës me një ndalesë; - Ngritja e kapaciteteve vendore; - Thjeshtëzim dhe qartësim i procedurave; - Përmirësim i shërbimeve publike.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët dhe personat e interesuar për të ndërtuar dhe investuar në Bashkinë Peqin. Disa nga përfitimet kryesore të këtij projekti konsistojnë në: - Përsheptim të afateve për pajisjen me leje ndërtimi; - Zvogëlim të burokracive administrative; - Zvogëlim të kostove ekonomike për aplikuesit për leje ndërtimi; - Tërheqjen e investitorëve si rrjedhojë e përmirësimit të cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit.
• Rendi prioritar	5 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm dhe në kombinim me dy projektet e mëparshme për ngritjen e kapaciteteve vendore dhe hartimin e PPV për Bashkinë, ofron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e territorit të Peqinit.

• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të zgjasë për një periudhë 4 mujore deri në implementimin e plotë të tij. Disa nga aktivitetet kryesore të parashikuara përfshijnë: - Përcaktimin e vendit (zyrës), ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për Zhvillimin e Territorit; - Përcaktimi dhe plotësimi i stafit të përfshirë në këtë zyrë; - Trajnimi i stafit dhe njohja me dispozitat ligjore dhe proceduriale bazuar në Ligjin 107/2014 “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Plotësimi me bazën materiale si kompjutera, printera, internet, orendi zyre etj.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazë koncepti. Bashkia duhet të përzgjedhë vendin, ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për zhvillimin e territorit dhe më pas të ndiqen hapat e sipërpërmendura.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar VKM “Për Zhvillimin e Territorit”.

DIVERSIFIKIMI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

PROJEKT 4	
• Titulli i projektit	Pastrimi dhe Rikonstruksioni i Kanaleve të Ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Peqin
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin
• Buxheti total i projektit	55,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 1-5% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU
• Përshkrimi i projektit	Bujqësia është një ndër sektorët më të rëndësishëm ekonomik në Bashkinë e Peqinit. Veçanërisht në njësitë administrative Gjocaj, Shezë, Pajovë, Karinë dhe Përparim është baza kryesore e ekonomisë, ku mbi 70% e popullsisë janë të punësuar. Prodhimi bujqësor, vështirësohet dhe shtohen kostot si rrjedhojë e mungesës së investimit në kanalet e ujitjes dhe kullimit. Gjithashtu, mos pastrimi dhe dëmtimi i kanaleve përbën një problem të madh edhe në rastin e rreshjeve të mëdha të shiut, pasi një pjesë e madhe e tokave bujqësore pranë lumit Shkumbin janë në rrezik konstant të përmytjeve. Projekti konsiston na pastrimin dhe përmirësimin e kushteve (rikonstruksionin) të kanaleve të ujitjes dhe kullimit në bashkinë Peqin. Ai është i ndarë në disa faza dhe ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Për secilën fazë do të aplikohet tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i punës konsiston në pastrimin dhe rikonstruksionin e kanaleve të ujitjes dhe kullimit. - Mbështetje të rritjes së produktivitetit; - Mbështetje të fermerëve; - Mbrojtje të Ujërave dhe Tokës Bujqësore; - Mbrojtja nga Përmytjet.
• Rezultatet e pritshme	- 70% e popullsisë është e punësuar në bujqësi, kështu që investimi pritet të sjellë një reduktim të kostove dhe vështirësive në prodhimtari; - Mbrojtje nga përmytjet.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti do të shoqërohet me masat përkatëse dhe parashikimet e duhura financiare në buxhetimin e ardhshëm të Bashkisë në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e kanaleve të pas-truara/rikonstruktura.
• Aktivitetet e projektit	2016-2018 (36 Muaj) Disa nga aktivitetet kryesore të projektit konsistojnë në: - Përcaktimin e saktë të zonave në nevojë për ndërhyrje;

	- Përgatitjen e dokumentacionit për aplikim për fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU; - Projekti mund të aplikohet edhe sipas fazave të mëposhtme: Faza 1- Gjocaj; Faza 2- Pajovë; Faza 3- Kaninë; Faza 4- Shezë; Faza 5- Përparim.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Fillimisht Bashkia duhet të përgatisë hartën dhe ndërhyrjet primare në kuadër të pastrimit, dhe më pas segmentet e sistemit, të cilat kanë nevojë për rikonstrukcion. Pas përgatitjeve të projekteve teknike duhet aplikuar tek FZHR.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave- Ujitja dhe Kullimi dhe Mbrojtja nga përmbytja e Tokave Bujqësore (2014) - Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Draft- 2016)

PROJEKT 5	
• Titulli i projektit	Ngritja e Qendrës së Grumbullimit dhe Tregut Rajonal
• Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik
• Vendndodhja e projektit	Pajovë, Vendndodhja e tregut ekzistues (17,680 m2)
• Buxheti total i projektit	40,000,000-45,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 1% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU Sektori i Bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Peqin. Rreth 70% e punësimit është e bazuar në këtë sektor, çka reflekton rëndësinë që sektori ka në ekonominë vendore. Ndër produktet kryesore bujqësore e blegtorale mund të përmenden frutorët (veçanërisht vreshtaria), ullinjë dhe perimet. Gjithashtu, edhe mbarështimi i shpendëve (gjelat e detit dhe pulat) luan një rol të rëndësishëm. Edhe pse është një ndër sektorët dominues të ekonomisë, fermerët vazhdojnë të hasin probleme në gjetjen e tregjeve dhe shitjen e produkteve të tyre. Një tjetër problematikë është dhe mungesa e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve apo dhe informaliteti në këtë sektor. Ndërkohë, edhe agro-përpunimi që është një potencial i madh për këtë zonë është në nivele shumë të ulëta, pjesërisht si rrjedhojë e vështirësisë për të grumbulluar produkte. Projekti parashikon ndërtimin e një qendre unike në llojin e saj. Kërkon të integrojë në një zonë të vetme Qendrën e Grumbullimit dhe Tregun Rajonal. Kombinimi i këtyre dy aspekteve, pra grumbullim dhe tregëtim rrit eficiencën dhe mundësitë e produkteve për të arritur në tregje më të gjera. Gjithashtu, në kuadër të Qendrës së Grumbullimit do të vendosen dhe aparaturat e nevojshme për kontrollin e cilësisë së produkteve. Në këtë mënyrë dhe produktet, të cilat më pas kalojnë në Tregun Rajonal mund të shfrytëzojnë të njëjtat facilitete. Qendra e Grumbullimit do të shërbejë edhe si zyrë këshillimore për fermerët, ndërkohë që tregu do të ketë dhe një seksion të dedikuar për farat. Ky kompleks i integruar, Grumbullim dhe Treg, do të ketë dhe ambjentet e nevojshme për trajtimin e mbetjeve organike me anë të kompostimit. Në këtë mënyrë krijohet një cikël i plotë i trajtimit të produktit si dhe i reduktimit të mbetjeve.
• Përshkrimi i projektit	Qëllimi i projektit është mbështetja e prodhimeve vendase. - Siguri për produktet bujqësore; - Rritje e tregtimit të produkteve bujqësore; - Mbështetje ndaj fermerëve; - Ngritje kapaciteti (duke operuar edhe si qendër trajnimi).
• Qëllimi dhe objektivat	

• Rezultatet e pritshme	Rreth 70% e punësimit në Bashkinë Peqin është e bazuar në bujqësi. Si rrjedhojë masa përfitimeve pritet të prekë një gamë të gjerë të popullsisë. - Krijimi i vendeve të reja të punës në kuadër të Qendrës së Grumbullimit dhe Tregut Rajonal (të paktën 30-40 vende pune, nga të cilat do të përfitojnë të dy gjinitë); - Mbështetja e fermerëve (trajnime, konsultime, kontroll sigurie të produkteve etj).
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti fillimisht do të menaxhohet nga Bashkia. Më pas do të ngrihen strukturat për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tij me anë të partneriteteve publike-private.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë: - Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik); - Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU; - Ndërtimi i Qendrës së Grumbullimit; - Ndërtimi i ambjenteve të tregut; - Ngritja e zyrës për kontrollin e cilësisë dhe këshillimit të fermerëve; - Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike me anë të kompostimit; - Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Projekti duhet të shoqërohet me një Vlerësim të ndikimit në Mjedis. Një ndër çështjet më kryesore, e cila lidhet me mbetjet organike që mund të gjenerohen nga qendra dhe tregu është parashikuar në projekt. Qendra parashikohet të ndërtohet në ambjentet ekzistuese të tregut, duke përmirësuar cilësinë e tyre dhe zbutur ndikimin në mjedis. Gjithësesi, një VNM duhet hartuar pasi të ketë mbaruar faza e projektimit të qendrës dhe tregut.
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten: - Studim fizibiliteti - Projekt Teknik - VNM
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është në kuadër të strategjisë së Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për ngritjen e tregjeve dhe qendrave të grumbullimit. Gjithashtu bazohet në hartën e rajonalizimit të produkteve bujqësore dhe përbën një incentivë për zbatimin e kësaj politike.

Figura 19: Skema e Funksionimit të Cluster-it të Bujqësisë (bashkangjitur në Aneks-in 2)

PROJEKT 6	
• Titulli i projektit	Promovimi dhe Brandimi i Bashkisë Peqin
• Tipi i Projektit	Marketim / Zhvillimi Ekonomik
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin
• Buxheti total i projektit	750,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 50% Donacione të tjera të mundshme
• Përshkrimi i projektit	Në territorin e Bashkisë Peqin gjenden një numër i konsiderueshëm objetesh kulturore, historike (p.sh. rruga historike Egnatia). Gjithashtu, Bashkia Peqin ofron një peizazh fantastik, me një kombinim të peizazhit të ofruar nga Lumi Shkumbin, tokat bujqësore si dhe zonat kodrinore e malore. Produktet bujqësore dhe potenciali për të zhvilluar agro-turizmin në forma të ndryshme është shumë i madh, por mungon promovimi i këtyre potencialeve, të cilat do të shtonin mundësitë për zhvillimin ekonomik si dhe zhvillimin rural. Përtej disa aktiviteteve sporadike, nuk ekziston një strategji e integruar dhe gjithëpërfshirëse për ofrimin e informacionit apo zhvillimin e aktiviteteve. Projekti synon rritjen e vizibilitetit të Bashkisë Peqin dhe promovimit të potencialeve. Projekti përbëhet nga disa hallka të lidhura me njëra tjetrën, si krijimi i një “marke” të dedikuar për Peqinin. Krjimi i një faqeje interneti për komunikimin me publikun, vizitorët dhe promovimin e potencialeve e aktiviteteve që zhvillohen në Peqin. Krijimin e një kalendari aktiviteteve me synim promovimin e Peqinit bazuar në vizionin dhe prioritetet e ngritura në Planin Operacional për Zhvillimin Lokal. Prodhimin e broshurave, materialeve informative, vendosjen e tabelave informuese për potencialet e bashkisë.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është promovimi i potencialeve të Bashkisë Peqin. Objektivat janë: - Krijimi i një brand (marke) për Bashkinë Peqin; - Promovimi i produkteve bujqësore dhe potencialeve për agro-turizëm; - Promovimi i potencialeve natyrore; - Krijimi i një kalendari aktiviteteve me fokus promovimin e potencialeve të Peqinit.
• Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme: - Përfitues janë të gjithë banorët e Bashkisë; - Rritja e numrit të vizitorëve; - Rritja e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e investitorëve; - Promovimi i Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
• Rendi prioritar	6 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Ky projekt është një ndër masat e buta, të cilat duhen marrë për zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Ai është i ndërlidhur me projektet e tjera në funksion të bujqësisë, zhvillimit rural e zhvillimit ekonomik të Bashkisë Peqin.

	Gjithashtu, promovimi i potencialeve natyrore, kulturore e historike rrit vetëdijen e banorëve për rëndësinë e tyre, si dhe ndihmon në mbrojtjen e tyre nga dëmtimi.
• Aktivitetet e projektit	Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 6 muajsh dhe përfshin aktivitetet e mëposhtme: - Krijimi i një logo-je për Brandimin e Bashkisë Peqin; - Krijimi i databazës për potencialet natyrore, kulturore, historike e peizazhistike; - Krijimi i një liste aktivitetesh promovuese si panaire, festivale, konferenca, seminare; - Krijimi i faqes elektronike që ofron informacionin për promovimin e Bashkisë; - Hartimin e broshurave e materialeve të tjera promovuese.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Për implementimin e tij, Bashkia duhet të përgatisë dokumentat për tenderim, si dhe të llojë për gjetjen e fondeve.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

Figura 20: Skema për Krijimin e Fondit të Turizmit
(bashkangjitur në Aneks-in 2)

INFRASTRUKTURA RRUGORE

PROJEKT 7	
• Titulli i projektit	Ngritja e vendqëndrimit të mjeteve të transportit të pasagjerëve (autobuza, minibusë, stacion treni)
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Stacioni i Trenit, Pajovë
• Buxheti total i projektit	18,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore
• Përshkrimi i projektit	Për momentin vendqëndrimi i mjeteve të transportit ndërrurban për pasagjerë është pozicionuar në qendër të Peqinit, pranë Kalasë. Ky vendqëndrim nuk është i përshtatshëm dhe shkakton trafik të panevojshëm në orët kryesore të lëvizjes. Gjithashtu nuk është i lidhur me forma të tjera të transportit si tren, pedalim, etj. Dëmton gjithashtu imazhin e qytetit dhe të kalasë së Peqinit si objekt i rëndësisë kulturore e historike. Mungon informacioni mbi oraret, biletaria e shërbime të tjera në funksion të udhëtarëve. Për të zgjidhur këtë problematikë, projekti synon krijimin e një vendqëndrimi të ri për mjetet e transportit të pozicionuar pranë stacionit të trenit. Projekti përbëhet nga: - Vendet e qëndrimit dhe parkimit të mjeteve; - Zyrat e shërbimit ndaj qytetarit, si biletari dhe informacion; - Vend pritje; - Rikonstruksion i stacionit të trenit; - Rigjenerim i zonës;
• Qëllimi dhe objektivat	Rregullim i trafikut dhe i ndërlidhjes në Peqin. - Sistem i rregullt transporti ndërrurban; - Orare strikte dhe kushte të përshtatshme shërbimi; - Rritja e sigurisë së transportit publik; - Shmangia e trafikut të rëndëruar dhe rrëmujës në brendësi të qytetit, apo përgjatë rrugëve.
• Rezultatet e pritshme	Rezultatet duhet te detajohen: - Përfitues janë banorët e Bashkisë Peqin, përfshirë gratë, të cilat rezultojnë se janë përdoruese të shpeshta të transportit publik; - Përmirësim i ofrimit të shërbimit të transportit ndërrurban; - Zbutje e trafikut dhe konfuzionit në lidhje me transportin; - Ndërlidhje më e mirë rajonale.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i ndërlidhur me vizionin dhe prioritetet e përcaktuara në POLZH. Ai synon strukturimin më të mirë të transportit ndër-urban.

	Rigjenerimi i zonës së stacionit të trenit ndikon në përmirësimin e cilësisë së zonës si dhe të imazhit të Bashkisë.
Aktivitetet e projektit	Kohëzgjatja e punimeve të projektit është parashikuar 16 muaj. Aktivitetet kryesore përfshijnë: - Hartimin e Projektit për Zbatim; - Aplikimin për fonde; - Përgatitjen e zonës dhe implementimin e projektit.
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Projekti duhet të shoqërohet me një VNM të përgjithshme, pasi nuk ka premisa për të shkaktuar dëme në mjedis.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Për zbatimin e tij duhet përgatitur projekti i detajuar për zonën. Më pas të kryhet aplikimi tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 8	
• Titulli i projektit	Përmirësimi i Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin (përgjatë rrugës nacionale Rogozhinë-Elbasan dhe Hekurudhës)
• Buxheti total i projektit	12,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 15% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.
• Përshkrimi i projektit	Bashkia Peqin përshkohet në mes nga dy akse të forta si rruga nacionale Rogozhinë-Elbasan dhe Hekurudha. Të dyja këto akse shpesh bëhen burim aksidentesh si rrjedhojë e mungesës së sinjalistikës së përshtatshme dhe urave të kalimit për këmbësorë. Për këtë arsye, projekti synon përmirësimin e sinjalistikës me qëllim rritjen e sigurisë në rrugë për këmbësorë dhe automjete. Projekti parashikon vendosjen e sinjalistikës rrugore në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale. Gjithashtu vendosjen e sinjalistikës së përshtatshme në kalimet në nivel midis rrugëve dhe hekurudhës. Vendosjen e dy urave të kalimit për këmbësorë përgjatë aksit kombëtar Rogozhinë-Elbasan. Në fund mbylljen e kalimeve informale ose vendosjen e sinjalistikës për rritjen e sigurisë përgjatë hekurudhës.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rritja e sigurisë rrugore. Objektivat konsistojnë në: - Uljen e numrit të aksidenteve; - Rritjen e sigurisë për këmbësorë përgjatë aksit Rogozhinë-Elbasan; - Rritjen e sigurisë në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale Rogozhinë-Elbasan; - Rritjen e sigurisë në kryqëzimet midis hekurudhës dhe rrugëve.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues të këtij projekt janë të gjithë banorët e Peqinit si dhe të gjithë udhëtarët në aksin Rogozhinë-Elbasan. Rezultati kryesor i projektit është reduktimi i aksidenteve rrugore.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti synon të rrisë qëndrueshmërinë në funksionimin e sistemit infrastrukturor rrugor dhe qarkullimit automobilistik në akset kryesore e më të ngarkuara të Bashkisë së Peqinit. Pajisja me sinjalistikën dhe infrastrukturën e duhur shërbyese, do të rrisë sigurinë e kryrjes së aktiviteteve të ndryshme përgjatë këtyre akseve, si dhe do të kontribuojë në dhënien e një orientimi më të mirë të qytetarëve dhe vizitorëve, në lidhje me të gjitha aktivitetet që zhvillohen aty.

• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 16 muajsh dhe parashikohen aktivitetet e mëposhtme: - Vendorsja e sinjalistikës në hyrjet dhe daljet e rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan; - Vendorsjen e sinjalistikës dhe mjeteve mbrojtëse në kalimet në nivel midis hekurudhës dhe rrugëve; - Përcaktimin e vendit për pozicionimin e dy urave të kalimit për këmbësorë, përgjatë rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit, por mund të kalojë për zbatim brenda një afati kohor të shkurtër. Një ndër hapat e parë që Bashkia duhet të ndërmarrë është përcaktimi i vendeve për vendosjen e sinjalistikës rrugore, si dhe përcaktimi i vendeve për kalimet këmbësore.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Kodi Rrugor

PROJEKT 9	
• Titulli i projektit	Përmirësimi i ndriçimit rrugor në qytetin e Peqinit
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Qytet Peqin
• Buxheti total i projektit	15,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.
• Përshkrimi i projektit	Qyteti i Peqinit (Census 2011) ka një popullsi prej 6,500 banorësh. Ndriçimi rrugor ekziston vetëm përgjatë bulevardit “Mustafa Gjinishi”, ndërkohë në rrugët e tjera është i mangët ose i dëmtuar. Kjo gjë shkakton një problematikë të theksuar në lidhje me sigurinë në rrugë, si edhe në lidhje me kryerjen e veprave të ndryshme penale, përfshirë veprat penale për shkak të seksit. Projekti konsiston në pajisjen me ndriçim rrugor të disa akseve të qytetit të Peqinit. Me anë të këtij projekti kërkohet që të rinovohet edhe sistemi ekzistues, duke aplikuar ndriçues të cilët përdorin energjinë në mënyrë eficiente (llampa të posaçme panele diellore etj.). Në këtë kontekst do të ri-modelohet sistemi i ndriçimit të rrugëve: - Mustafa Gjinishi - Ismail Bej Kadiu - Abdurrahim Pasha - Sulejman Pasha - Ramazan Cani Rimodelimi i këtij sistemi ndriçimi rrugor për bllokun e kufizuar nga këto rrugë do të shërbejë si nismë që më pas të zgjerohet i gjithë rrjeti i ndriçimit në qytet, duke përdorur teknologji të lartë si panelet për ‘vetëmbështetje’ nga pikëpamja energjitike. Blloku i përcaktuar ka një perimetër prej 1.2km. Shtyllat të vendosen 1.0-1.5 m larg nga bordurat. Vendosja e tyre duhet të shkojë sipas ritmit të drunjëve. Mënyra e ndriçimit varet nga gjërësia e rrugëve. Për rrugë me gjerësi deri në 12 m ndriçuesit vendosen vetëm në një anë të rrugës. Për rrugë me gjerësi deri 18 m ndriçuesit varen mbi rrugë dhe për gjerësi mbi 40 m ndriçuesit vendosen në të dy anët e rrugëve. Ndriçimi në kryqëzimin e rrugëve duhet të jetë më i fuqishëm se ndriçimi i rrugës që kryqëzohet. Ndriçimi në këto nyje mund të jetë i ndryshëm nga ai i rrugëve, ndërkohë që ndriçimi i shesheve duhet të jetë 50 % më i fortë se ai i rrugëve që hyjnë në të.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i sistemit të ndriçimit rrugor në qendër të qytetit të Peqinit. Disa nga objektivat janë: - Rritja e sigurisë rrugore;

	- Modernizim i sistemit të ndriçimit; - Përdorim i ndriçuesve me efikasitet të lartë energjitike dhe që prodhojnë energji me anë të panelve apo formave të tjera për kapjen e energjisë diellore.
• Rezultatet e pritshme	Disa nga rezultatet e pritshme përfshijnë që nga projekti të përfitojnë rreth 6,500 banorë. Përfitimi do të jetë jo vetëm për banorët, por edhe për bizneset që operojnë në këtë zonë pasi ndryshon dhe imazhi i qendrës së Peqinit. Pritet gjithashtu zvogëlim i kostove të energjisë elektrike për ndriçim rrugor, duke qënë se projekti bazohet në ndriçues, të cilët prodhojnë vetë një pjesë të madhe të energjisë. Duke rritur sigurinë rrugore dhe reduktuar veprat penale për shkak të seksit , pritet të ketë një integritet më të madh të të rinjve, sidomos të gjinisë femërore në aktivitetet dhe jetën sociale të qytetit, si edhe parandalim të akteve të dhunës të kryera ndaj tyre.
• Rendi prioritar	6 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti ka një nivel të lartë të qëndrueshmërisë: - Së pari sepse bazohet në metodat e përdorimit eficient të energjisë elektrike, pra do të kontribuojë në ngritjen e një sistemi ndriçimi të qëndrueshëm dhe rrjedhimisht me pak shpenzime (në terma afatgjatë) për Bashkinë; - Së dyti, sepse do të ndikojë në plotësimin e rrjetit të ndriçimit për të gjithë qytetin e Peqinit (për t'u zgjeruar më pas në një fazë të dytë, edhe në Njësitë e tjera Administrative); - Së treti sepse do të kontribuojë në rritjen e sigurisë në qytet, duke nxitur më tej pjesëmarrjen më aktive të të rinjve, dhe sidomos femrave në aktivitete të ndryshme dhe jetën sociale; - Së katërti, do të ul kriminalitetin në këtë Bashki dhe do të reduktojë veprat penale, përfshirë ato të kryera ndaj grave.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh. Disa nga aktivitetet kryesore konsistojnë në: - Përcaktimin e akteve kryesore dhe sasisë ekzakte të ndriçuesve; - Përcaktimin e saktë të teknologjisë që do të përdoret për ndriçuesit; - Aplikimin për fonde; - Implementimin e projektit.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të kryhet një studim i detajuar për sasinë ekzakte të ndriçuesve dhe teknologjive që do të përdoren. Më pas duhet aplikuar për fonde të FZHR.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Kodi Rrugor

PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

PROJEKT 10	
• Titulli i projektit	Përmirësimi i cilësisë së Shkollave 9-vjeçare
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Arsim
• Vendndodhja e projektit	Njësitë Administrative: Peqin dhe Gjocaj
• Buxheti total i projektit	29,743,867 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar.
• Përshkrimi i projektit	Shkollat 9-vjeçare në Bashkinë Peqin përgjithësisht kanë nevojë për rikonstruksion, pasi janë në gjendje jo të mirë. Ndërtesat janë të amortizuara dhe nuk ofrojnë ambiente të përshtatshëm për mësimdhënie. Strukturat janë të vjetëruara dhe kanë mangësi në izolim e termo-izolim, duke rritur mjaft kostot e përdorimit të mjeteve alternative për të siguruar kushtet e përshtatshme gjatë periudhës së pikut, në verë dhe dimër. Gjithashtu mungojnë dhe mjetet teknologjike si laboratore apo kompjutera. Për këtë arsye është e rëndësishme që të përmirësohet situata në mënyrë që të rritet interesi i nxënësve për shkollën si dhe për të vijuar më tej me formimin e tyre akademik. Projekti konsiston në rikonstruksionin dhe përmirësimin e godinave të dy shkollave 9-vjeçare, një në qytetin e Peqinit dhe tjetra në Njësinë Administrative Gjocaj; dhe ndërtimin e një strukture të re për shkollë 9-vjeçare “Demir Godelli” në qytetin e Peqinit, godina aktuale e së cilës është në kushtë kritike. Projekti për ndërtimin e strukturës së re është bërë dhe është i gatshëm për implementim. Secila prej tyre do të marrë edhe funksione shtesë dhe të shërbejë edhe si qendër komunitare për njësitë, në të cilat ato ndodhen. Qëllimi i këtyre qendrave komunitare do të jetë ofrimi i trajnimeve dhe konsultimi i grave në zonat rurale. Gjithashtu aty do të ketë edhe kurse dhe trajnime jashtë-shkollore për të rinjtë. Shkollat do të ofrojnë dhe ambiente sportive.
• Qëllimi dhe objektivat	- Përmirësimi i cilësisë dhe kushteve të shkollave 9-vjeçare; - Shkollat si qendra komunitare; - Nxitja e arsimimit tek fëmijët e këtyre zonave.
• Rezultatet e pritshme	- Kushte më të mira dhe performancë më e mirë nga nxënësit dhe mësuesit e shkollave 9-vjeçare, kushtet e të cilave do të përmirësohen; - Gratë si përfituese të shërbimeve të qendrës komunitare; - Rritje e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën 9-vjeçare.
• Rendi prioritar	7 / 10

Qëndrueshmëria e projektit	Rikonstruksioni dhe ndërtimi i shkollave në Bashkinë Peqin do të shoqërohet me implementimin dhe prezatimin e teknikave bashkëkohore të efikasitetit energjitike, qoftë në termoizolim, ashtu edhe në pajisjet e ndriçimit dhe kushtet e kondicionimit. Këto do të rrisin qëndrueshmërinë e projektit në terma afatgjatë, dhe do të bëjnë më efikas investimin. Gjithashtu aktivizimi i një shkolle edhe si qendër komunitare do të ketë një ndikim pozitiv dhe në mirëmbajtjen e ambjenteve të saj. Ndër të tjera qendra do të shërbejë për sensibilizimin e familjeve për të nxitur fëmijët në vazhdimin e formimit të tyre edukativ.
Aktivitetet e projektit	Koha e duhur për realizimin e kësaj projekti është 36 muaj dhe përshin fazat e mëposhtme: - Faza 1: Rikonstruksioni i dy shkollave - Hartimi i projektit të detajuar; - Rikonstruksion i shkollave dhe konvertim në qendra për komunitetin; - Faza 2: Ndërtimi i shkollës së re - Gjetja e fondeve të financimit; - Shembja e shkollës së vjetër dhe bërja gati e terrenit për punime; - Ndërtimi i strukturës së re.
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për rikonstruksionin e dy shkollave 9-vjeçare është në fazë ideje. Më tej është e nevojshme që të hartohen projektet teknike për të dyja shkollat që do të rikonstruktohen. Projekti për ndërtimin e shkollës së re është i gatshëm. Do të duhet të bëhet rishikimi i preventivit dhe më pas të bëhet terreni gati për ndërtimin e strukturës së re. Për implementimin e kësaj projekti do të shembet objekti ekzistues dhe struktura e re do të ndërohet në po të njëjtën vendndodhje.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 11	
• Titulli i projektit	Rikonstruksioni i 3 Ambulancave në Njësitë Administrative Pajovë dhe Gjocaj
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Shëndetësi
• Vendndodhja e projektit	3 Ambulanca – një në Njësinë Administrative Pajovë dhe dy në fshatrat Gjocaj dhe Kurtaj në Njësinë Administrative Gjocaj.
• Buxheti total i projektit	18,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për shëndetësinë.
• Përshkrimi i projektit	Situata e ndërtesave të Ambulancave në Bashkinë Peqin, dhe sidomos në zonat rurale, është mjaft e dobët. Shumë prej tyre janë të amortizuara dhe në nevojë për rikonstruksion. Gjithashtu, edhe përsa i përket pajisjeve nga vizitat në terren, vërehet që ka mangësi. Projekti konsiston në përmirësimin e godinave të 3 ambulancave: 1 në Njësinë Administrative Pajovë, dhe 2 të tjera në Njësinë Administrative Gjocaj, përkatësisht në fshatrat Gjocaj dhe Kurtaj. Projekti është i ndarë në disa faza dhe secila fazë konsiston me përmirësimin e cilësisë së një strukture. Punimet që duhet të bëhen konsistojnë edhe në zëvendësimin dhe rregullimin e paisjeve elektrike dhe hidraulike, duke filluar nga paisja me priza, ndriçimi dhe shkarkimi i ujrave. Përmirësimi i këtyre kushteve do të sigurojë ambiente më të sigurta dhe më të mira për pacientët. Për krahasim me përmirësimin e aspektit fizik të ndërtesave, e rëndësishme është edhe pajisja me mjete të specializuara për kryerjen e kontrolleve mjekësore.
• Qëllimi dhe objektivat	- Përmirësimi i cilësisë së ofrit të shërbimit shëndetësor; - Plotësimi me pajisje për kontrollin shëndetësor; - Përmirësimi i kushteve të ndërtesave të spitalit dhe qendrave shëndetësore.
• Rezultatet e pritshme	- Përfitues të projektit janë të gjithë banorët e këtyre zonave; - Gratë dhe nënat e reja; - Të moshuarit.
• Rendi prioritar	9 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm dhe lidhet me një sërë masash të tjera të cilat do të ndërmarrë Bashkia. Gjithashtu, Bashkia do të sigurojë masat e përshtatshme për mirëmbajtjen e qendrave.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Mund të aplikohet në faza ose si një i tërë. - Faza 1: Ambulanca në Njësinë Administrative Pajovë

	- Faza 2: Ambulanca në fshatin Gjocaj, në Njësinë Administrative Gjocaj; - Faza 3: Ambulanca në fshatin Kurtaç, në Njësinë Administrative Gjocaj.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të hartohet projekti i detajuar si përsa i përket rikonstruksionit të ndërtesave, ashtu dhe përsa i përket nevojës për plotësim me aparatura dhe mejte të tjera pune.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

MIRËQËNIA SOCIALE DHE EKONOMIKE

PROJEKT 12	
• Titulli i projektit	Ngritja e Zyrës së Punës në Peqin
• Tipi i Projektit	Social
• Vendndodhja e projektit	Qendër Peqin, Pronë Shtetërore pranë Bashkisë, ose Qendra Kulturore
• Buxheti total i projektit	700,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 100%
• Përshkrimi i projektit	Bashkia Peqin ka një shifër të lartë papunësie, veçanërisht tek të rinjtë (...%) dhe tek grate (...%). Kjo vjen deri diku si rrjedhojë e mbështetjes së ekonomisë vendase, kryesisht në sektorin bujqësor ndërkohë që sektorët e tjerë të shërbimeve dhe industrisë janë shumë të vegjël për të gjeneruar punësim për të gjithë. Për këtë arsye, ky projekt konsiston në hapjen e zyrës së punës në Bashkinë Peqin, e cila do të kontribuojë veçanërisht edhe në diversifikimin e vendeve të punës dhe rritjen e mundësive për punësim tek të rinjtë dhe gratë. Zyra e punës do të jetë ose brenda ndërtesës së bashkisë, ose tek Qendra Multifunksionale Ferdinand Deda. Fondi i parashikuar shërben për përgatitjen e ambjenteve të zyrës dhe bazën materiale për funksionimin e saj. Zyra duhet të ketë një staf prej 3-5 veta dhe përtej regjistrimit të të papunëve duhet të shërbejë si urë lidhëse midis bizneseve dhe qytetarëve.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është hapja e një zyre pune në Bashkinë Peqin. Ky projekt ka si objektiva: - Uljen e nr. të papunësisë tek të rinjtë; - Uljen e nr. të papunësisë tek gratë; - Ndërlidhjen midis punëdhënësve dhe punëmarrësve; - Rritjen e aftësive/trajnimin e qytetarëve në bazë të kërkesave të tregut; - Ofrimin e kurseve profesionale për grupe në nevojë si të rinj, të reja dhe gra të papuna.
• Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme të aplikimit do të përfshijnë: - 10,000 përfitues të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë, të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere për mbi 1,000 nxënës të shkollave të mesme të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere dhe trajnim për të rinj të papunë, të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim dhe trajnim për gratë e papuna; - Mundësi punësimi për të rinjtë, të reja dhe gratë e papuna si edhe qytetarët e tjerë të trajnuar.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti lidhet me një sërë masash të tjera nga pikëpamja sociale si dhe për përmirësimin

	e shërbimeve publike. Ky projekt do të jetë i qëndrueshëm në momentin që aktivitetet lidhen ngushtësisht edhe me Qendrën Kulturore. Projekti synon jo vetëm gjetjen e mundësive për punësim nga zyra e punës, por dhe kurse të trajnimit profesional të të papunëve me qëllim aftësimin e tyre për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut. Ofrimi i kurseve profesionale do ti afrojë më shumë qytetarët e papunë (të ndarë sipas gjinisë) me punëdhënësit potencialë.
• Aktivitetet e projektit	Projekti ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe përfshin: - Përcaktimi ne vendit të zyrës; - Rregullimin e ambjenteve të punës dhe plotësimin me material; - Gjetjen dhe trajnimin e stafit; - Krijimin e lidhjeve strategjike me Bizneset lokale; - Organizimin e eventeve trajnuese dhe “networking” midis punëdhënëses-punëmarrës; - Organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave lokale.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është ende në fazën e konceptit. Duhet që bashkia të përcaktojë vendin për zyrën, (Brenda në Bashki ose Qendër Kulturore Ferdinand Deda), plotësimin e zyrës me staf, plotësimin e zyrës me materiale pune dhe ambjente pritjeje të qytetarëve.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 13	
• Titulli i projektit	Rikonstruktimi dhe fuqizimi i Qendrës Multifunkzionale Kulturore Peqin
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Sociale
• Vendndodhja e projektit	Qendra Kulturore “Ferdinand Deda”
• Buxheti total i projektit	23,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar.
• Përshkrimi i projektit	Bashkia Peqin me reformën e re territoriale ka një popullsi prej rreth 38,000 banorësh, duke pasur një rritje të konsiderueshme të grupmoshave të reja dhe grupeve të ndryshme të interesit. Mënyrësisht në Bashki Qendra Kulturore “Ferdinand Deda” është pika, ku zhvillohen aktivitetet e ndryshme që prekin të rinjtë, por në anën tjetër ka grupe, interesat dhe nevojat e të cilave kjo qendër nuk i mbulon me profilin që ka. Aktivitetet e Qendrës Kulturore janë të pakta. Ajo ka një rol pasiv në komunitet. Gjithashtu, nuk përdoret për qëllime të tjera si qendër trajnimesh, qendër për ndërveprim social, qendër jashtë-shkollore për të rinjtë, qendër për rritjen e kapaciteteve të grave, qendër për mbështetjen e këtyre të fundit etj. Ky projekt parashikon të jetë një katalizator i jetës sociale në Peqin për shkak të karakterit social dhe edukues. I përbërë nga dy nënprojekte synon të ketë një impakt të gjërë dhe gjithëpërfshirës, duke plotësuar nevojat aktuale të qytetit. Aktorët e përfshirë janë bashkia Peqin, ministritë përkatëse për aktivitet kulturore dhe kurset profesionale, OJF-të, organizatat dhe banorët. Kthimi i qendrës “Ferdinand Deda” në Qendrën Multifunkzionale të Bashkisë do të nxisë më tej integrimin në jetën sociale të grave, të të rinjve, popullsisë Rome dhe Egjiptiane, personave me aftësi të kufizuara, etj., duke siguruar mundësinë për të zbutur diferencat e theksuara gjinore dhe sociale që ekzistojnë në qytet. Qendra “Ferdinand Deda” do të rikonstruktohet dhe do të përshtatet për të ofruar edhe hapësira të tilla si: - Vend për trajnime; - Vend për këshillime për karrierë; - Vend për këshillimin e grave; Qendra Multi-funkionale do të bashkëpunojë me Zyrën e Punës Peqin për të kryer funksionin e ndërlidhjes midis bizneseve dhe të papunëve, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rikonstruksioni i Qendrës Kulturore dhe rimodelimi i saj në një Qendër Multifunkionale. Ndër objektivat janë: - Përmirësimi i jetës sociale në Peqin; - Aktivizimi i të rinjve në aktivitete jashtë-shkollore

	- Trajnimi i të rinjve; - Ngritja e kapaciteteve për punësim tek gratë; - Mbështetja dhe integrimi i grave në shoqëri
• Rezultatet e pritshme	Rezultatet duhet te detajohen (në varësi të projektit): - Banorët e Bashkisë Peqin; - Të rinjtë; - Nxënësit e shkollave të mesme; - Popullsia e gjinisë femërore (sidomos gratë e papuna).
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm pasi lidhet edhe me një sërë masash të tjera, të cilat Bashkia duhet të ndërmarrë në lidhje me çështjet sociale si papunësia tek të rinjtë, apo problematika të çështjeve gjinore. Gjithashtu, pas rimodelimit të Qendrës Kulturore “Ferdinand Deda” në një Qendër Multifunkionale, Bashkia do të formojë bordin drejtues dhe strukturat menaxhuese, të cilat do të kujdesen për mirëmbajtjen. Një pjesë e fondeve do të gjenerohen nga Bashkia, ndërkohë që pritet që Qendra Multifunkionale të aftësohet gjithashtu për të gjeneruar të ardhurat e saja, duke aplikuar me anë të projekteve në programe dhe donatorë të ndryshëm.
• Aktivitetet e projektit	Kohëzgjatja e projektit është parashikuar në 16 muaj. Disa nga aktivitetet përfshijnë: - Përgatitjen e projektit të detajuar të qendrës, - Aplikimi për fonde dhe implementimi i projektit; - Ngritja e bordit drejtues dhe strukturave menaxhuese; - Promovimi i Qendrës Multifunkionale; - Ndërlidhja me OJQ dhe Programe të ndryshme; - Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të zhvillohet projekti i detajuar teknik. Të vijohet më tej me gjetjen e kontakteve të interesuara për bashkëpunim. Aplikimi për fonde.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 14	
• Titulli i projektit	Rigjenerimi i fasadës së Kalasë dhe Banjove Publike
• Tipi i Projektit	Kulturë/Historik
• Vendndodhja e projektit	Kalaja e Peqinit
• Buxheti total i projektit	30,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për kulturën dhe Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.
• Përshkrimi i projektit	Në qytetin e Peqinit ndodhet dhe Kalaja e Peqinit. Një objekt historik, i cili si pasojë e mungesës së fondeve është lënë pas dore, duke mos u shfrytëzuar si një potencial ekonomik. Përtej mungesës së investimeve në Kala, pranë saj gjenden banjot publike, të cilat janë në kushte shumë të këqia dhe përbëjnë rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive, përtej faktit që dëmtojnë rëndë imazhin e qytetit. Pranë Kalasë gjithashtu është edhe vendqëndrimi i mjeteve të transportit ndërrurban, i cili shpesh krijon trafik dhe kaos në këtë zonë. Projekti ka si synim rigjenerimin e murit të kalasë së Peqinit dhe të banjove publike. Fillimisht do të ndryshohet vendqëndrimi i mjeteve të transportit, duke e çliruar këtë hapësirë për qytetarët. Më pas do të pastrohen dhe rikonstruktohen banjot publike në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më i pastër për qytetarët. Në fund, muri i kalasë do të pastrohet, restaurohet në pjesë të cilat mund të ketë nevojë, të vendoset një system ndriçimi i cili nxjerr në pah bukurinë e kalasë dhe e respekton atë në të njëjtën kohë.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i imazhit të qytetit dhe fuqizimi i rolit të Kalaja, si monument me rëndësi historike për Bashkinë e Peqinit. Ndër objektivat kryesore përmendim: - Përmirësimi i imazhit të qytetit; - Mbrojtja e monumenteve historike; - Krijimi i hapësirave publike për qytetarët; -Krijimi i ambjenteve tërheqëse për vizitorët; - Pastrimi i banjove publike.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues direkt të këtij projekti do të jenë banorët e qytetit të Peqinit (rreth 6,500 banorë), ndërkohë në mënyrë indirekte do të jenë të gjithë banorët e Bashkisë. Rezultate të tjera të pritshme janë edhe rritja e numrit të vizitorëve dhe stimulimi për gjetjen e fondeve për restaurimin e plotë të Kalasë Peqin.
• Rendi prioritar	7 / 10

• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm pasi lidhet me një sërë masash, politikash dhe projekte të tjera të cilat do të ndërmerren nga Bashkia Peqin. Do të krijohet një fond për mirëmbajtjen e murit të Kalasë. Përsa i përket banjove publike do të aplikohet një shumë simbolike për përdoruesit në mënyrë që të garantohet pastrimi dhe mirëmbajtja e tyre. Gjithashtu, në një fazë të dytë do të aplikohet për restaurimin e plotë të Kalasë dhe shndërrimin e saj në një objekt/muze historik për qytetin. Kalaja gjithashtu është e lidhur me projektin e ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për “Rrugën historike Egnatia”.
• Aktivitetet e projektit	Projekti ka një kohëzgjatje prej 6 muajsh dhe përfshin: - Pastrimin e zonës nga mbetjet; - Gjetjen e vendit për zhvendosjen e banjove publike; - Pastrimin dhe rigjenerimin e mureve të kalasë; - Pajisjen e Kalasë me ndriçim dhe tabela përkatëse të sinjalistikës dhe informimit; - Shqyrtimin e mundësive për restaurimin e plotë të Kalasë në të ardhme, në një fazë të mëvonshme.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A. Duhet një Konfirmim nga IMK (Instituti i Monumenteve të Kulturës) për ndërhyrjet në fasadën e kalasë Peqin.
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Për implementimin e tij është e rëndësishme që të ndërmerren disa faza përgatitore si: - Përgatitja e projektit të detajuar në bashkëpunim me IMK; - Aplikim për fonde; - Implementimi i projektit dhe promovimi i kalasë Peqin.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti për rivitalizimin e rrugës historike “Via Egnatia”- AKB

PROJEKT 15	
• Titulli i projektit	Ri-konceptimi i Pyllit të Pishave dhe kthimi i tij në Park Rekreacional.
• Tipi i Projektit	Rekreacion
• Vendndodhja e projektit	Pylli i Pishave, Peqin
• Buxheti total i projektit	15,000, 000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti Konkurses për Infrastrukturën Vendore
• Përshkrimi i projektit	Pylli i Pishave është një ndër hapësirat kryesore rekreative në qytetin e Peqinit. Gjithësesi aty nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi apo komoditeti për ta konsideruat atë si një hapësirë kualitative rekreative. Duke qënë se është e vetmja zonë e gjelbër, ka një frekuentim të lartë sidomos gjatë fundjavave. Për këtë arsye me anë të këtij projekti synohet që të përforcohet aspekti i Pyllit të Pishave si një hapësirë rekreative në qytetin e Peqinit. Projekti do të konsistojë në një rikonceptim të pyllit nga pikëpamja e “peizazhit” si dhe përmirësim të shërbimeve të ofruara në të. Do të shtohen terrene sportive për sporte si futboll, tenis, basketboll, voleyboll. Gjithashtu do të krijohet një palestër e hapur, e shoqëruar me hapësira për vrapim. Do të vendosen 30 stola, 30 kosha për mbeturina si dhe do të mbillen 50 pisha të reja dhe do të ndriçohet e tërë zona, për të siguruar kështu përdorimin në çdo kohë të kësaj hapësire. Gjithashtu, rru- ga, e cila të sjell për tek Pylli i Pishave do të plotësohet me sinjalistikë (tabela informuese) si dhe do të shtohet gjelbërimi. Duke qënë se kjo hapësirë përdoret kryesisht nga të rinjtë, gratë me fëmijë dhe moshat e treta, rikualifikimi i kësaj zone ka mjaft rëndësi për mbështetjen e këtyre grupeve, duke rritur sigurinë në zonë dhe duke nxitur më tej gjithëpërfshirjen e tyre në aktivitetet e ndryshme dhe jetën sociale të qytetit të Peqinit.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është zgjerimi i hapësirave rekreative cilësore për qytetarët e Bashkisë Peqin. Objektivat janë: - Ri-kualifikim i Pyllit të Pishave si hapësirë rekreative; - Rikualifikim i terreneve sportive; - Përshtatje me mobilim “urban” për të gjitha grupmoshat; - Nxitja e gjithëpërfshirjes sociale të të rinjve, moshës së tretë dhe grave.
• Rezultatet e pritshme	- Përfitues direkt të projektit do të jenë 6,500 banorët e qytetit të Peqinit; - Përfitues të tjerë do të jenë banorët e Njësive Administrative të tjera; - Ngritja e dy fushave të futbollit (mini futboll); - Krijimi i 1 fushë tenisi; - Krijimi i 1 fushë basketbolli; - Krijimi i 1 fushë voleybolli;

	- Krijimi i Palestrës së Hapur në natyrë; - Vendosje e 30 stolave; - Vendosje e 30 koshave për mbeturina; - Mbajllja e 50 pishave të reja; - Pajisja me ndriçim e të gjithë zonës.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti do të jetë i qëndrueshëm pasi ndërlidhet me një sërë masash të tjera që është duke ndërmarrë bashkia. Për përdorimi e disa prej terreneve sportive do të aplikohet një shumë simbolike, e cila do të ndihmojë në mirëmbajtjen e shtimin e pishave.
• Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit parashikohen 12 muaj. Puna do të konsistojë në: - Hartimin e projektit; - Bërjen gati të zonës për ndërhyrje; - Mbajllja e 50 pishave të reja; - Pajisja me ndriçim e zonës - Krijimi i zonave sportive; - Krijimi i zonës së lojrave për fëmijë; - Pajisja me 30 stola; - Pajisja me 30 kosha për hedhjen e mbetjeve.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Fillimisht duhet të hartohet projekti i detajuar pastaj të aplikohet për fonde tek FZHR.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

MJEDISI

PROJEKT 16

• Titulli i projektit	Hapja e vend-depozitimit të ri të mbetjeve dhe mbyllja e atij ekzistues
• Tipi i Projektit	Shërbime publike/ Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Vend-depozitimi ekzistues - masat për mbylljen e tij. Vend-depozitimi i ri do të vendoset në një parcelë me një sipërfaqe prej 7,000m ² me nr. pasurie 108/1 dhe ZK 3055, në Qytetin Peqin.
• Buxheti total i projektit	45,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore.
• Përshkrimi i projektit	Sheshi aktual i depozitimit të mbetjeve urbane ndodhet në dalje të qytetit, e vendosur pranë rrugës nacionale. Bazuar në të dhënat e marra nga Ministria e Zhvillimit Urban ky vend-depozitim është jashtë standarteve. Ai është jo sanitar dhe i dëmshëm për mjedisin. Ky vend-depozitim jo vetëm që është ndotës për mjedisin, por përbën gjithashtu një rrezik konstant për shëndetin e banorëve të Bashkisë Peqin. Si rrjedhojë e mungesës së standarteve, ky vend-depozitim është i rrezikshëm edhe përsa i përket ndotjes së ujërave nëntokësore dhe lumit Shkumbin, i cili është ndër furnizuesit kryesor me ujë, i tokave bujqësore. Projekti parashikon në rradhë të parë studimin e detajuar të problemeve të vend-depozitimit ekzistues. Marrjen e masave për mbylljen e tij dhe më pas konvertimin e kësaj hapësirë të ndotur në një zonë të gjelbër. Në gjelbërimin e zonës do të përdoren bimësi, të cilat do të bëjnë rigjenerimin dhe rehabilitimin natyror të zonës. Hapi i dytë i këtij projekti përfshin hapjen e një vend-depozitimi të ri në një parcelë prej 7,000m² me nr. pasurie 108/1 dhe ZK 3055, në kushte dhe standarte sipas legjislacionit në fuqi. Ky projekt duhet të shoqërohet me VNM. Gjithashtu, vend-depozitimi i ri duhet të jetë i rrethuar dhe duhet të shoqërohet me sinjalistikën e infrastrukturën e nevojshme.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i situatës së menaxhimit të mbetjeve urbane. Objektivat janë: - Mbyllja e vend-depozitimit ekzistues; - Hapja e një vend-depozitimi të ri me kushte dhe standarte të larta.
• Rezultatet e pritshme	- Numri i përfituesve do të jetë i barabartë me të gjithë banorët e Bashkisë Peqin; - Ndër përfitimet e tjera janë ulja e ndotjes mjedisore; - Reduktim i rreziqeve për sëmundje, si rrjedhojë e kushteve jo-sanitare të vend-depozitimit ekzistues.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti do të jetë i qëndrueshëm pasi do të shoqërohet me masa të tjera të ndërmarra nga Bashkia për menaxhimin e mbetjeve, të tilla si mirëmbajtja e vend-depozitimit

	Gjithashtu vend-depozitimi ekzistues do të shndërrohet në një hapësirë të gjelbër. Edhe vend-depozitimi i propozuar do të pajiset me një fashë të gjelbër përreth, për të ndaluar në këtë mënyrë çdo ndotje të mundshme të zonave përbri, transmetimin e aromave të ndryshme, si dhe për të mos u shndërruar në një ndotje vizuale për zonën.
Aktivitetet e projektit	Koha e planifikuar për realizimin e projektit është 22 muaj. Disa nga aktivitetet kryesore të tij përfshijnë: - Përgatitjen e projektit teknik të detajuar; - Hapjen e vend-depozitimit të ri; - Mbylljen e vend-depozitimit ekzistues; - Gjelbërimin e zonës së vend-depozitimit ekzistues.
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Projekti duhet të shoqërohet me një VNM të detajuar, duke qënë se ka impakt të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në shëndet.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Fillimisht duhet kryer studimi i detajuar i vend-depozitimit ekzistues dhe kapacitetit të tij. Gjithashtu në studim duhet të përcaktohen masat e sakta inxhinierike e mjedisore, të cilat duhet të ndërmerren për mbylljen e tij. Më pas duhet të studiohet zona e propozuar për vend-depozitimin e ri si dhe të hartohet projekti i detajuar bazuar në standartet për hapjen e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane. Ky projekt duhet të shoqërohet me VNM. Më pas do të kryhet aplikimi për fonde dhe do të implementohet projekti.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A


PROJEKT 17	
• Titulli i projektit	Projekt Pilot, Kompostimi në Bazë Ferme
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë/ Mjedis
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Peqin
• Buxheti total i projektit	3,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurues për infrastrukturën rrugore; - OJQ - Programe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; - Etj.
• Përshkrimi i projektit	Sheshi aktual i depozitimit të mbetjeve urbane ndodhet në dalje të qytetit e vendosur pranë rrugës nacionale. Projekti synon uljen e impaktit mjedisor të shkaktuar nga rryma e mbetjeve urbane si dhe rritjen e ndërgjësimit të banorëve për gjurmën e tyre në mjedis. Një sasi e madhe e mbetjeve në Peqin vjen nga bujqësia. Promovimi i kompostimit në bazë ferme është një përpjekje për të ulur sasinë e mbetjeve. Gjithashtu ky projekt do të përdoret më pas si një shembull dhe një model i mirë për t'u shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë. Projekti do të fokusohet kryesisht në promovimin e kompostimit kryesisht në zonat rurale, duke qenë se për shkak edhe të karakteristikave ato janë më të përshtatshme për ta zhvilluar këtë lloj aktiviteti. Kompostimi në familje konsiston në trajtimin vetëm të mbetjeve organike të gjeneruara nga ajo. Kompostimi është një proces i thjeshtë dhe efikas për të ulur rrymën e mbetjeve që depozitohet në kosha, e në të njëjtën kohë i kthen mbetjet organike në pleh, i cili mund të përdoret më vonë në bujqësi. Për kryerjen e kompostimit nevojitet një kosh me përmasa 1m3, i cili mund të pozicionohet në pjesën e mbrapme të shtëpisë. Proçesi i formimit të kompostit final konsiston në : hedhjen e produkteve me përmbajtje azoti (mbetje drusore, gjethe, kashtë) dhe produkteve me përmbajtje karboni (mbetje kafe, mbetje ushqimore, bar i prerë etj.) Më tej këto produkte përzihen në praninë e ujit në mënyrë që të jenë gjithmonë të lagështa dhe të ajrosura me oksigjen.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi kryesor i këtij projekti është ndërgjegjësimi i fermerëve në lidhje me mbetjet dhe aplikimi i kompostimit në bazë ferme. - Ulja e rrymës së mbetjeve që depozitohen në kosha; - Trajtimi i mbetjeve organike dhe kthimi i tyre në pleh; - Rifutja e mbetjeve organike në ciklin e aktivitetit bujqësor; - Trajnimi i sa më shumë familjeve, për ta kthyer kompostimin në një praktikë të rregullt, në të gjithë Bashkinë.

• Rezultatet e pritshme	- Fillimisht nga projekti do të përfitojnë 50 fermerë - Ndërgjegjësim në lidhje me mbetjet organike - Mundësi të reja nga kompostimi.
• Rendi prioritar	6 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm pasi lidhet ngushtësisht me projektin për vend-depozitim të ri të mbetjeve. Pas aplikimit të tij do të monitorohet në mënyrë konstante dhe më pas do të përdoret si model edhe për fermerët e tjerë. Qëndrueshmëria e projektit garantohej edhe nga fakti se në këtë proces, një rol të rëndësishëm do të luajnë dhe vetë fermerët.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 6 muajsh dhe parashikohen disa aktivitete: - Përzgjedhja e fermerëve; - Trajnimi i tyre; - Shpërndarja e koshave; - Diseminimi i njohurive tek fermerët e tjerë.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të përzgjidhen fermerët; të përgatiten kurikulat për trajnimin e tyre; të shpërndahen koshat dhe më pas të monitorohet ecurshmëria e projektit.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

HARTOGRAFIA E FISHAVE

(SHPËRNDARJA NË TERRITOR E PROJEKTEVE)


INFRASTRUKTURA RRUGORE



INFRASTRUKTURA

FISHA 7: Ngritja e vendqëndrimit të mjeteve të transportit të pasagjerëve (autobuza, minibusë, stacion treni)

FISHA 8 : Përmirësimi i Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore.




EKONOMIA DHE BUJQËSIA

FISHA 5: Ngritja e Qendrës së Grumbullimit dhe Tregut Rajonal.

FISHA 9: Përmirësimi i ndriçimit rrugor në qytetin e Peqinit.

FISHA 13: Rikonstruktimi dhe fuqizimi i Qendrës Multifunkionale Kulturore Peqin (funksionimi edhe si qendër trajnimesh profesionale).




SHËRBIMET PUBLIKE

FISHA 7: Ngritja e vendqëndrimit të mjeteve të transportit të pasagjerëve (autobuza, minibusë, stacion treni).

FISHA 10: Përmirësimi i cilësisë së Shkollave 9-vjeçare.

FISHA 13: Rikonstruktimi dhe fuqizimi i Qendrës Multi-funkionale Kulturore Peqin.

FISHA 14: Rigjenerimi i fasadës së Kalasë dhe Banjove Publike.



REKREACIONI

FISHA 6: Promovimi dhe Brandimi i Bashkisë Peqin.

(Ndërhyrje për rivitalizimin e hapësirave kryesore publike në zonat e banuara të Bashkisë)

FISHA 14: Rigjenerimi i fasadës së Kalasë dhe vënia e saj në funksion si objekt turistik (përfshirja në guida etj.);


FISHA 15: Ri-konceptimi i Pyllit të Pishave dhe kthimi i tij në Park Rekreacional.

ANIMIME


(ILUSTRIME MBI PROJEKT FISHAT / PARA-PAS NDËRHYRJEVE)

FISHA 6: PROMOVIMI DHE BRANDIMI I BASHKISË PEQIN

1.LOGO



2.WEBSITE




3.BROSHURE


FISHA 7: NGRITJA E VENDQËNDRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT PASAGJERË



FISHA 8: PËRMIRËSIMI I SINJALISTIKËS DHE SIGURISË RRUGORE



FISHA 14: RIGJENERIMI I FASADËS SË KALASË DHE BANJOVE PUBLIKE




FISHA 15: RI-KONCEPTIMI I PYLLIT TË PISHAVE DHE KTHIMI I TIJ NË PARK REKREACIONAL



FISHA 15: RI-KONCEPTIMI I PYLLIT TË PISHAVE DHE KTHIMI I TIJ NË PARK REKREACIONAL



FISHA 17: PROJEKT PILOT, RICIKLIMI DHE KOMPOSTIMI NË BAZË FERME



BRANDIMI DHE PROMOVIMI I PRODUKTEVE DHE NËN-PRODUKTEVE VENDASE NË TREGUN LOKAL DHE ATË RAJONAL





ANEKSI 2

(GRAFIKË DHE HARTA PLOTËSUESE)

FIGURA 2: LIDHJET STRATEGJIKE TË BASHKISË PEQIN NË RAJON



FIGURA 5: ELEMENTËT E FORTË TERRITORIALË DHE EKONOMIKË




FIGURA 9: HARTA E RRJETIT HIDROGRAFIK




FIGURA 10: HARTA E TOKAVE




FIGURA 13 / 1 : HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE RREZEVE TË MBULIMIT (KOPSHTET)




FIGURA 13 / 2 : HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE RREZEVE TË MBULIMIT (SHKOLLAT 9-VJEÇARE)




FIGURA 13 / 3 : HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE RREZEVE TË MBULIMIT (SHKOLLAT E MESME)




FIGURA 14: HARTA E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE DHE RREZEVE TË MBULIMIT




FIGURA 15: HARTA E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM




FIGURA 16: HARTA E KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA



FIGURA 17 / 1: HARTA E INFRASTRUKTURËS KRYESORE RRUGORE




FIGURA 17 / 2: HARTA E INFRASTRUKTURËS KRYESORE RRUGORE (AKSESI)




FIGURA 19: SKEMA E FUNKSIONIMIT TË CLUSTER-IT TË BUJQËSISË





FIGURA 20: SKEMA PËR KRIJIMIN E FONDIT TË TURIZMIT



PEMA E PROBLEMATIKAVE:

